# Shqipëria etnike

| E mërkure 24 maj 2017 | Viti XVII nr 159 | Çmimi 30 L / 1 euro | E pavarur, periodike | www.shqiperia-etnike.com shqiperia_etnike@yahoo.com | English, page 13-15 | Drejtor Sokol Pepushaj |
|---|---|---|---|---|---|---|




Në fund, ju nuk vlerësoheni se sa shumë keni ndërmarrë, por çfarë arrini në fund!

**TRUMP**



MARRËVESHJA RAMA-BASHA

Fitim Zekthi

faqe 7



LIGJI I RI I PRONAVE NUK ZGJIDH...

Ben Blushi

faqe 6



SHEJTORJA ISHTE GONXHE

Aleksandër Çika

faqe 4

# Marrëveshja Rama-Basha dhe emrat e Qeverisë Teknike. Zgjedhjet parlamentare më 25 qershor




## Ilir Meta: Marrëveshja Rama-Basha. Koalicionet. LSI dhe Presidenca

**INTERVISTA E KRYETARIT TË KUVENDIT, Z. ILIR META NË EMISIONIN "ZONË E LIRË" TË GAZETARIT ARJAN ÇANI NË TV KLAN / FAQE 10-11, 16**



## Sheikët tanë...



**Nga Ermira Therqaj**

Në gjuhën shqipe, sheik quhet ai që ka pasuri shumë të madhe dhe zakonisht u referohemi vëndeve arabe, ku popujt shfrytëzohen dhe nafta përdoret për përfitime të shpejta të një grupi njerëzish të lidhur me pushtetin.

Por kjo fjalë ka zënë vënd edhe në fjalorin tonë. Megjithëse niuveli ekonomik është mjeran, sheikë janë shumë. Dhe cilët janë?

Janë pikëtrisht qeveritarët e ish qeveritarët, ministrat e ish ministrat, deputetët e ish deputetët, gjyqtarët e prokurorët, gjithë administrata dhe ish administreata e shtetit në 26 vitet e fundit. Pra, nga viti 1991, ku medemek Shqipëria... / faqe 3

## Historia e shteteve te bashkuara të Amerikës

Banorët e parë të njohur në territorin e sotëm të Shteteve të Bashkuara besohet të kenë ardhur aty gjatë një periudhe prej disa mijëra vitesh, e cila filloi diku rreth 15,000 - 50,000 vjet më parë, duke e kapërcyer... / faqe 14

## Dilni shihni nëpër Shkodër...

**- Reportazh-**



**Nga Sokol Pepushaj**

Për ty që nuk e ke vizituar prej vitesh Shkodrën, duhet të vihesh në kërkim të imagjinatës, ... / faqe 12

## Diaspora shqiptare vazhdon të mbështesë Partinë Demokratike. Socialistët reagojnë.

Pamjet nga aktivitete të ndryshme politike nga SHBA, veçanërisht ngjarjet për mbledhjen e fondeve, kanë bërë lajme këtu dhe Partia Demokratike ... / faqe 2

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Diaspora shqiptare vazhdon të mbështesë Partinë Demokratike. Socialistët reagojnë.







Pamjet nga aktivitete të ndryshme politike nga SHBA, veçanërisht ngjarjet për mbledhjen e fondeve, kanë bërë lajme këtu dhe Partia Demokratike është përfituesi më i madh deri tani, ndërsa Partia Socialiste është e shqetësuar.

Është një fakt i njohur se pjesa më e madhe e diasporës shqiptare në SHBA është kryesisht katolike ose e krishterë dhe se fakti që Lulzim Basha, Kryeministri i mundshëm i ardhshëm në Shqipëri, i ofendoi ata duke thënë se «Partia Socialiste po rekruton katolikët - shqiptarë të veriut, shumica e të cilëve kriminelë, për të vjedhur zgjedhjet», nuk e dobësojnë lidhjen e Diasporës me partinë e tyre tradicionale, Partinë Demokratike. Z. Basha që nga ajo kohë i kërkoi falje komunitetit katolik dhe duket se e kanë falur atë, veçanërisht ata që jetojnë në SHBA.

"Ne kemi pasur mbi 200 njerëz në javën e fundit, e cila është një nga shumë takime, që kemi mbajtur deri tani", tha Endrit Xhikneli, organizatori i këtij aktiviteti në Hartford, Konektikat, ku ata folën për të ardhmen e partisë dhe për mbështetjen që Diaspora mund t'i japë asaj. "Mbi 25 mijë dollarë u mblodhën vetëm atë natë", tha z. Xhikneli, i cili foli me ne në telefon. Për më tepër, këta shqiptaro-amerikanë duket se janë të gatshëm që të vijnë në Shqipëri, për të bërë fushatë dhe për të votuar për partinë e tyre.

"Ne po organizojmë komunitetin shqiptaro-amerikan në Nju Jork, Konektikat, Miçigan dhe vende të tjera për t'u përfshirë në zgjedhjet e këtij viti në Shqipëri", tha Ilir Kola, familja e të cilit është e lidhur ngushtë me Bashën.

"Ne jemi të nderuar nga anëtarët e familjeve tona në SHBA, dhe u jemi borxhli atyre. Ne vlerësojmë punën që ata po bëjnë dhe jemi të sigurt se çdo dollar, që ata po mbledhin për ne, do të shpenzohet me qëllim që të mposhtim Edi Ramën dhe partinë e tij", tha Basha, i cili konfirmoi se ishte takuar me shqiptarët në SHBA disa herë në të kaluarën, ku kishin diskutuar rëndësinë e përfshirjes së Diasporës në zgjedhjet e këtij viti.

"U pyetëm mbrëmë nga Agjentët Shqiptarë të Sigurisë rreth punës sime politike dhe përfshirjes politike të djalit tim në SHBA. Dhe e di se edhe të tjerët kanë të njëjtin problem", tha Ermir Xhinkeli, babai i Endrit Xhinkelit. "Ata dinin gjithçka për djemtë dhe shokët e tij në SHBA. Me të vërtetë më kanë frikësuar, se ata dinin aq shumë për ta", vazhdoi Z. Xhinkeli.

"Diaspora, sidomos katolike nga veriu i Shqipërisë, më së shumti ishte e zhgënjyer me Sali Berishën që nga viti 2005, por duket sikur po e falin partinë për atë kohë", tha Sander Lelcaj, një veprimtar politik në rrethin e Shkodrës. "Ne kemi dëgjuar për rastin kur autoritetet po i frikësojnë anëtarët e familjes së atyre shqiptarëve, që jetojnë në SHBA, duke u përpjekur t'i bindin ata, që të ndalojnë të afërmit e tyre në SHBA që të mbështesin demokratët, si financiarisht ashtu edhe politikisht", tha A. Hoti, një aktivist në degën Malësi e Madhe.

"Asnjë katolik, qoftë në SHBA apo Shqipëri, nuk duhet të votojë për Bashën, apo partinë e tij", thotë Anxhelo Briska, këshilltar politik për Partinë Socialiste. "Ai i fyeu ata dhe fenë e tyre. Ai i quajti ata kriminelë dhe në vitin 2005, Topalli i quajti ata terroristë. Si mund ta mbështesin ende këtë parti?", vazhdoi z. Briska.

A munden që zgjedhjet e këtij viti të vendosen nga diaspora jonë? Mbetet për t'u parë, por të dyja palët, po kërkojnë mbështetjen e tyre.

**Redaksia e gazetes**

# Sheikët tanë...

Nga: Ermira Therqaj

Në gjuhën shqipe, sheik quhet ai që ka pasuri shumë të madhe dhe zakonisht u referohemi vëndeve arabe, ku popujt shfrytëzohen dhe nafta përdoret për përfitime të shpejta të një grupi njerëzish të lidhur me pushtetin.

Por kjo fjalë ka zënë vënd edhe në fjalorin tonë. Megjithëse niveli ekonomik është mjeran, sheikë janë shumë. Dhe cilët janë?

Janë pikëtrisht qeveritarët e ish qeveritarët, ministrat e ish ministrat, deputetët e ish deputetët, gjyqtarët e prokurorët, gjithë administrata dhe ish administreata e shtetit në 26 vitet e fundit. Pra, nga viti 1991, ku medemek Shqipëria e ndërroi sistemin nga komunist ne demokrat, nuk është berë as edhe një hap përpara. Sipas një shkrimi që tronditi Europën disa vite më parë, botuar në gazetën Corriere della Sera nga gazetari Ettore Mo, vetëm në 20 vite ishin pushkatuar mbi 20 000 shqiptarë të pafajshëm, vetëm për mungesën e ligjit dhe lidhjeve të mafias me politikën.

Dhe pikërisht, janë kjo kategori mafioze që është pasuruar. Pra, gjithgë pushtetarët e ish pushtetarët sot kanë pasuri marramëndëse, megjithëse rrogat e tyre janë shumë të vogla.

Saheikët tanë shesin mënd me makina shume të shtrejta, bizhuteri, supervila e prona miliona dollarëshe.

Ju kujtojmë këtu mesazhin që dha ambasadori amerikan Donald Lu në një takim me gjyqtarë e prokurorë në një Konferencë Gjyqësore Kombëtare para disa kohësh:

**"Nëse ulni kokën dhe shikoni kyçet e duarve e aty mbani një orë që kushton më shumë se makina ime, jeni të korruptuar. Nëse është ky rasti, iu rekomandoj që ta lini këtë profesion menjëherë".**

Pra, aty në gjyqësor ka milionerë si Gjin Gjoni që ka deklaruar mbi 1 milion euro pasuri me rrogë qesharake. Ne, vetëm duke iu referuar deklarimeve të tyre, mund të themi se sheikët e mëdhenj janë pikërisht drejtuesit e shtetit e ky popull, I nënshtruar tashmë nga dhuna e padrejtësitë, vetëm hesht, nuk gjën force të protestoi.

**PASURIA E ÇIFTIT KRYEMINISTROR**

Kryeministri Edi Rama është pronar me



100 për qind i një apartament banimi në Tiranë, tip parafabrikat me sipërfaqe 59 m2, fituar me privatizim, sipas rivlerësimit të 2012 vlera 5 422 100 lekë. Ai është po ashtu pronar me 100 për qind i studios "Artisti" në Tiranë, me sipërfaqe 65 m2, me trashëgimi nga babai, me vlerë të raportuar 2 500 000 Lekë. Rama është bashkëpronar me 50 % e ku 50% të tjera pjesë e regjimit martesor me bashkëshorten Lindita Rama. Po ashtu me bashkëshorten ai është bashkëpronar i një shtëpie banimi me sipërfaqe të padeklaruar, përcaktuar një kat, me vlerë ndërtimi 39 607 741 lekë, vendndodhja e shtëpisë në fshat Surrel, Komuna Dajt, pasuri që justifikohet me dokument leje ndërtimi, momenti i deklarimit është pa titull pronësie. Bashkëshortja Lindita Rama si e pavarur nga regjimi martesor është pronare me 100 për qind e apartamentit sipërfaqe 146.15 m2 + verandë 68 m2 + garazh 17 m2, vendndodhja Tiranë, blerë me pjesë në 2015 dhe 2009. Po ashtu bashkëshortja Lindita Rama e pavarur nga regjimi martesor është pronare e tokës me sipërfaqe 4 483.5 m2 Surrel, Dajt, blerë në vitet 2005 dhe 2009, me titull pronësie për tokë arë. Edi Rama në llogari bankare personale ka një vlerë prej 2 007 789 lekë, burim të ardhurash paga e mëhershme dhe shitja e librit "Kurban". Ndërsa shuma kesh në vlerën 988 700 lekë, burim i të ardhurave si kursime personale. Rama ka një kredi në bankë të nivelit të dytë me vlerë detyrimi financiarë të pashlyer - 336 383 lekë, e marrë në datën 12. 05. 2000 me principal 2.5 milion lekë, afat shlyerje 15 vjet, interes bazë 3%. Çifti Rama ka detyrim të papaguar për shtëpinë e banimit në Surrel një vlerë prej 12 056 241 lekë. Ndërsa zonja Lindita Rama në cilësinë e bashkëshortes dhe me të drejta të pavarura nga regjimi martesor, zotëron vlerën e dhënë si hua të tretëve prej 70 000 euro, hua pa interes, e papërcaktuar data e huadhënies. Bashkëshortja Lindita Rama zotëron gjendje llogari bankare më 10. 09. 2013 në vlerën 6 206 644.3 lekë, deklarohet 100% pjesëtare.

**PASURIA E LULZIM BASHËS, SHEF I OPOZITËS**

Kryetari i Partisë Demokratike është pronar i një apartamenti banimi në Holandë në vlerën 229 500 euro. Shefi i opozitës është pronar i një apartamenti në Tiranë në vlerën 205 000 dollarë. Ai është po ashtu pronar i një apartamenti në Durrës në vlerën 33 000 euro. Bashkëpronar me 1/3 pjesë takuese i një apartamenti në Tiranë në vlerën 17 500



lekë. Bashkëpronar me 1/4 pjesë takuese i një apartamenti në Tiranë në vlerën 62 000 dollarë. Bashkëpronar me 1/4 pjesë takuese i një trualli me sipërfaqe 22 100 m2 në Tepelenë, rikthim prone në vitin 2004. Basha i ka të depozituar në një llogari bankare 52 000 dollarë, ndërsa në një tjetër llogari bankare ka të depozituara 81 000 euro. Në emër të tij figuron një veturë tip Mercedes Benz në vlerën 72 000 euro.

**SENDE ME VLERË**

Basha është pronar me 100 % i një pikture në vlerën 6 500 euro. Pronar me 100% i një ore dore në vlerën 5 200 euro. Pronar me 100 % i një ore dore në vlerën 4 500 euro. Pronar me 100% i një unaze diamanti në vlerën 11 500 euro. Pronar me 100 % i një servis porcelani në vlerën 6 800 euro. Ai është pronar me 100 % i aksioneve në NASDAQ në vlerën 18 000 dollarë. Ndërkaq Basha ka marrë një kredi bankare me principal me vlerë 204 000 euro, interes 4.2% dhe afat maturimi 7 vjet, për të cilin ka mbetur ende pa shlyer një vlerë prej 198 000 euro.

**PASURIA E ÇIFTIT META**

Paga e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Ilir Meta është 2 015 182 Lekë. Ndërkohë bashkëshortja, zonja Monika Kryemadhi, të ardhura nga paga dhe të tjera nga funksioni si deputete ka 2 629 956 lekë. Zonja Kryemadhi deklaron likuidim të kontratës së shitjes së apartamentit sipas deklarimit për vitin 2015 me vlerë totale 64 020 euro dhe gjendja e llogarisë ku është bërë hyrje në datën 31 dhjetor 2015 është 60 818 euro. Në llogarinë bankare zoti Meta ka një vlerë prej 1 815 082 lekë. Ndërsa zonja Kryemadhi ka në llogari bankare një vlerë prej 12 175 eurosh. Po ashtu në një llogari bankare dy emërore pjesëtarë të familjes figurojnë me 14 609 lekë. Gjatë vitit 2015 ka shlyer 12 036 Euro një kredi të mëparshme për



blerje apartamenti. Në datën 31 dhjetor 2015 kishte për të shlyer edhe 154 036 euro. Ndërsa zonja Kryemadhi deklaron një gjendje detyrimi me overdraft prej 1 235 677 lekë.

Sheikë pra kemi shumë. Sheikë mund të quajmë me plot gojën gjithë ministrat e ish ministrat, deputetët e ish deputetët, politikanët e ish politikanët, pushtetarët e ish pushtetarët që në vitin 1991 e këtej.

Janë pra këto pasuri përrallore, pasuri që në vëndet e zhvilluara nuk shihen as në ëndrra. E këta hajdutë pushtetarë nuk bëjnë asgjë tjetër vetëm në kohë votimesh bëjnë sikur zihen, por thjeshtë ndajnë pushtetin e vjedhin në pafundësi pasurinë e liritë e këtij populli.

# Demokristianët, viktima të terrorit politik e islamik

Të dhënat e mbledhura nga Regjistrimi i popullsisë mbi kombësinë dhe Besimin Fetar 2011, tregojnë se 57.12% janë deklaruar si myslimanë, 10.11% katolikë, ndërsa 6.8% ortodoksë. Ateistë janë deklaruar 2.52%, bektashinj 2.11%, ndërsa evangjelistë 0.11%. Kjo duke pyetur edhe shumë shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe që u ka rastisur të jenë përgjatë vitit 2011 në Shqipëri. Pra, pjesa katolike që jeton aktualisht në Shqipëri, është shumë më e vogël, ashtu siç është shumë më e lartë pjesa myslimane. Jemi sot vëndi unikal në Europë që altoperlantet e xhamive ndizen me volum të lartë pesë herë në ditë. Jemi vëndi më problemor edhe për furnizimin me vullnetarë në Siri të organizatës terroriste ISIS. Kështu katolikët, veçanërisht demokristianët, kanë qënë viktima të terrorit politik dhe islamik, pasi shtetin e kanë kapur grupe kriminale e terroriste. Vrasja me tritol e kryetarit të Partisë Demokristiane Dega Malësi e Madhe Aleksander Keka, më datën 18 qershor 2009, dhjetë ditë para zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009, u cilësua nga kryetari i Partisë Demokristiane Nard Ndoka: "vrasja politike dhe sulmi terrorist. Keka kërcënohej vazhdimisht nga politika terroriste dhe terrori islamik i fshehur pas politikës".



Edhe demokristiani i nohur shqiptar Mark Gurraj është një ndër viktimat pa faj, por që ishte projektuar për tu vrarë. Që atë vit të zi kur u vra Aleksander Keka, ai u anetaresua në Partine Demokristiane. Ishte marsi i vitit 2009, kur u krijua dega e kesaj partie në Milano, Itali, dhe Mark Gurraj u anëtarësua dhe punoi shumë për politikat social- ekonomike e morale të filozofisë kristiane. Demokristiani Gurraj ka dhënë ndihma financiare dhe Dega e Partisë Demokristiane Shqiptare në Milano ka grumbulluar fonde për PDKSH-në, sidomos për zgjedhjete parlamentare të 23 qershorit 2013 dhe zgjedhjet për pushtetin vëndor të 21 qershorit 2015. Shuma e fondeve nga emigrantët shqiptarë nga Italia per PDKSH-në i kalon 150 000 euro. Këtu ra në vemëndje të terroristëve demokristiani Mark Gurraj, i cili gjatë organizimit të dy autobusëve me rreth 80 emigrantë që erdhën të votojnë në Shqipëri më 21 qershor 2015, duket u bë shqetësues për politikën e terrorit dhe terrorin politik. Është kërcënuar disa herë nga persona të panjohur duke i thënë se po bëhesh shqetësues për pushtetin në Shqipëri. Mark Gurraj ka qënë edhe anëtar i Shoqatës së Emigrantëve Shqiptarë në Romë, ku ka ngritur zërin në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Itali kundër racizmit, diskreminimit e persekutimit nga ekstremistë neofashistë të Partisë Neofashiste të Xhanfranko Finit dhe Lega Nord të Umberto Bosit. Edhe karabinieria italiane për shkak te kombësisë shqiptare e ka trajtuar keq. Kjo ndoshta, pasi Shqipëria është vëndi kryesor që furnizon Italinë me drogë, ku është arritur të kapen deri në 12 ton ngarkesë droge vetem në një aksion të dekonspiruar. Pra, mafia e terrori sulmojnë njerëzit e ndershem dhe veçanërisht aktivistët per liri e të drejta njerëzore. Aktiviteti i demokristianit Mark Gurraj ka qënë publik, në takime, mitingje, postera, e ndihma finaciare për Paretinë Demokristiane Shqiptare, deri para rreth një viti që u detyrua të largohet nga Europa për të siguruar jetën që i rrezikohej. Edhe prindërit e tij kanë perkrahur Partinë Demokristiane që në krijimin e saj në vitin e largët 1991.

**Redaksia e gazetes**

# SHENJTORJA ISHTE GONXHE

Nga **Aleksander Çipa**

Engjejt dhe shenjteret nuk pronesohen, ata adhurohen dhe shnderrohen ne mite. Mitin, te gjallet e krijojne nga pak dhe sipas ligjesise se rrallesise. Ne verbin e rralle shpirteror te Nene Terezes dy aspekte kane mbetur te kthjellta dhe vecse brenda saktesise: Origjina shqiptare dhe drita shenjteruese e saj. Fqinji yne i paket, Republika me emer ende te diskutueshem, ajo ish Jugosllave e Maqedonise, tinezisht ne castet kur Vatikani ka nisur procesin e shenjterimit te Shenjtores se madhe shqiptare Gonxhe Bojaxhi, paraqet pretendimet per ta njohur gjenine, si te genit te tyre. Jo me kot fjaleurti Gete shprehej se "gjenite lakmohen si territoret". Historia e shqiptareve kohe pas kohe i ka shtyre fqinjet dhe historiberesit e tyre te mbeten fallsifikues dhe retushues biografish, vlerash dhe aktesh fondamentale. Sllavet gjithehere s'kane rreshtur te mbeten pretendues te autoresise eposale, malazeste ne librarite e tyre shtojne ende libra per origjinen nga nacioni i tyre te Migjenit apo disa emrave fondamentale te kultures dhe historise sone kombetare, greket ne jug pandreqshmerisht edhe me sekuestrues apo greqishtberes per shumecka shqiptare. As me pak e as me shume, pretendimi i tyre per Skenderbeun te ashtuquajtur prejt tyre si Jorgos, eshte rast i mjaftueshem i tendences dhe pervojes lakmuese. Por adresimi qeveritar maqedonas prane kryebashkiakut te Romes me bustin e "Nene Terezes", eshte nje akt i fundit atentatues ndaj shenjtores shqiptare. E mbrojtur ne perkatesine e saj qe nga emri e deri tek fisi genetik, qe nga pohimet e riperseritura dhe deri tek puthja pagane e tokes shqiptare, Nene Tereza, brenda drites se shpirtit, pati te plote driten e etnitetit te vet.



Tinezia zyrtare maqedonase per fallsifikim te ketij fakti biografik te Nene Terezes, le te merret si nje navitet fqinjor. Ndersa projekti i kryetarit te bashkise se Romes, kurresesi nuk mund te kurorezohet e as te percillet me ceremoni te tilla, pasi ne gjuhen e besimit te perbotshem eshte unike sentenca: Me engjejt dhe shenjtoret mos luaj.

Nene Tereza eshte imazhi real dhe bashkekohor i gjenialitetit shpirteror shqiptar. Ne kete mit te shumepare, shumendjere e te shumefalur natyrshem ne shqiptaret mbartim supremacine tone spirituale mbi bashkebotasit tane. Skaj me skaj te rruzullit Shenjtorja jone njihet me emrin Gonxhe. Semantikisht ky emer vetem me gjuhen shqipe e lidh perkatesine dhe sipas M.Heidegger: Gjuha eshte "qela e qenies".

Fqinjit te paket ia kuptojme humorin, sikunder rasti i fundem i tyre na rikujton shprehjen e famshme te Librit te Nastradinit: "Vjedhja gjithmone ndodh ne kopshtin qe ka".

Natyrisht fallsifikimi i perkatesise se bustit te Shenjtores nuk mund te pranohet ne Romen e lashte sepse ne kete rast nuk do ta kishte fjalen meria, por pesha e rende e mekatit qe behet me Shenjtoren. Ne Rome dominon dijenia per fjalen biblike: Me engjejt dhe shenjtet mos luaj! Dhe, Shenjtorja ishte Gonxhe.

# Tensionohet fushata elektorale në Veri

Fushata elektorale ka hyrë në një faze të ashpër, me tensione e dhunë. Partia socialiste, jo vetëm që po përdor elementët kriminal dhe paratë e drogës, por edhe bandat për presion ndaj kundërshtarëve politikë. Partia Socialiste, votat e 25 qershorit, tashmë pas daljes nga çadra të opozitës, duket se ka vëndosur ti blejë me çdo çmim, për të mbajtur me vandalizëm pushtetin e ngritur mbi krimin e korrupsionin.

Në veri, ku Ministri i Brëndshëm Saimir Tahiri ka liruar edhe kriminelë nga burgu, për ti përdorur në fushatë, gjëndja është tepër e rëndë. Shefi i opozitës Lulzim Basha ka denoncuar disa raste, ku opozita kërcënohet. Një ndër rastet e shumta është edhe kërcënimi i veprimtarit, anëtarit të komisioneve zgjedhore të PD prej 20 vitesh dhe anëtarit të Partisë Demokratike, Pjerin Kaçi, në qytetin e Shkodrës. Elementë të lidhur me krimin e pushtetin, e kanë paralajmëruar të shkëputet nga fushata dhe të mos shoqëroi në takime e aktivitete liderin demokrat Lulzim Basha. Kaçi, prej 20 vitesh njihet në Veri si aktivist i Partisë Demokratike dhe si pasardhës i një fisi të persekutuar nga regjimi komunist i Enver Hoxhës.

Persona të rëndësishëm të PS-së fshihen pas presioneve dhe personave që shpërndajnë para, duke blerë votuesit, edhe ditën për diell, dhe ku policia jo vetëm nuk ndërhynë, por edhe i ndihmon. Ngjarja tepër e rëndë që u regjistrua dy ditë më parë, në lagjen "Tre Heronj" të Shkodrës, ku persona të panjohur kanë grabitur e dhunuar fizikisht të miturin Kleidio Pjerin Kaçi, është akti më i turpshëm i bashkëpunëtorëve të kryeministri më të keq në historinë e shtetit tone. Kryeministri Edi Rama, pasardhës i diktaturës, siç po e quan opozita në gjithë takimet elektorale, ka mbjedhur vëndin me drogë dhe këto ditë po blen votues. Të miturin Kleidio Kaçi, rreth ores 18.00 të dates 22. 05. 2017, persona të panjohur dhe me maska e kanë grabitur në rrugë dhe pasi e kanë dhunuar fizikisht deri sa e kanë lënë pa ndjenja, e kanë çuar dhe hedhur afër shtëpisë. Është ky si duket presioni dhe paralajmërimi i fundit për babain e këtij adoleshenti Pjerin Kaçi, që don të thotë se kriminelët e shtetit vrasin edhe fëmijë vetëm e vetëm të mbajnë pushtetin.

Kjo situate dhune, ka frikësuar demokratët e thjeshtë, të cilët nën terror, janë të detyruar të mos marrin pjesë masivisht në takimet elektorale të opozitës shqiptare.

**Redaksia e gazettes**

# Shteti liron kriminelët nga burgu për ti përdorur gjatë fushatës elektorale

Pas rreth një muaji mbahen zgjedhjet parlamentare. Me ndërhyrjen direkte të kryeministrit Edi Rama, sipas shefit të opozitës Lulzim Basha, janë liruar shumë kriminelë të rrezikshëm nga burgu për tu përdorur në fushatë elektorale për të vjedhur votat e 25 qershorit. Janë liruar kriminelët Lul Berisha në Durrës, Emiljano Shullazi dhe nuk po arrestohet prej muajsh krimineli në kërkim ndërkombëtar Klement Balili. Të tre këta kriminelë të rrezikshëm i ka përmendur me emra ambasadori i SHBA në Tiranë Donald Lu. Deklarata e fortë e ambasadorit nuk e ka vënë në lëvizje shtetin e krimit që po rrezikon edhe jetën e punonjësve të policise, pasi kriminelët hakmerren edhe ndaj atyre qe i prangosën

Kohët e fundit çuditërisht u lirua nga burgu edhe krimineli shumë i rrezikshëm Gjovalin Kola ne prefekturen Shkoder. Shkodra gjithmonë ka qënë një zone e nxehtë krimi. Gjovalin Kola ishte arrestuar me datën 21.11.2012 dhe ishte i dënuar me 25 vite burg. Pra, sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës i takonte të përfundonte dënimin pas 20 vitesh. Ky person, i dënuar si trafikant droge, prostitucini, vrasje, dënohet 25 vjet dhe del nga dënimi në 5 vjet! Kjo ndodh vetëm në Shqipëri. Dhe ky kriminel ka edhe tre vëllezer të tjerë që si hakmarrje kërkojnë të vrasin policët e rajonit që ishin në aksionin e zbulimit dhe arrestimit të tij.

Gjovalin Kola dhe vellezerit e tij janë persona të njohur për shumë vepra kriminale në rajonin e Shkodrës. Ata njihen si trafikantë droge, prostitucioni dhe trafik të qënieve njerëzore.

Edhe familjarët e këtyre policeve ndihen te rrezukuar, pasi bandat kanë suport nga politika. Të gjithë këta dhe shumë të tjerë po përdoren nga shteti mafioz për të vjedhur me dhunë votat e 25 qershorit.

Një efektiv i Policisë së Shtetit, Sokol Gasper Gobeti, më datën 13.03.2017 pati një atentat nga bandat e drogës e prostitucionit, ku i vunë eksploziv, tritol, makinës së tij me targa SH 7692 C.

**Redaksia e gazetës**

# Zbulohen pasuritë e mëdha të krerëve të partive të vogla

Ato konsiderohen pati të vogla, madje edhe satelite të dy partive të madha, por kryetarët dhe përfaqësuesit e tyre në Parlament, posedojnë pasuri të pazakonta, në raport me nivelin e jetesës së shqiptarëve.

***AGRON DUKA DHE BEN BLUSHI***

Kreu u Partisë Agrare Ambintaliste, Agron Duka, rezulton me të ardhura modeste, për vitin që lamë pas. Duka deklaron 734 873 lekë gjendje në llogarinë e pagës, 3 215 844 lekë të ardhura dhe përfitime si deputet dhe 41 800 lekë të ardhura të bashkëshortes Fatbjana Duka nga paga në shoqërinë 'A.I.B.A KOMPANI'.

Vajza, Eva Duka, deklaron 99 264 lekë në llogarinë e pagës, 1 062 144 lekë pagën si administratore në shoqërinë 'ECO MARKET' dhe djali Andi Duka, 600 000 lekë pagën si specialist në shoqërinë 'ECO MARKET'. Kreu i LIBRA-s Ben Blushi thotë se gjatë vitit 2016, i janë pakësuar llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në shumat 2 827 720 lekë, 29 000 000 lekë, 5 884 euro dhe 569 lekë.

Deputeti Blushi deklaron 3 000 000 lekë pagesa për të drejtën e autorit nga UET, 1 648 091 lekë shtesë nga kreditimet për të drejtën e autorit nga UET si dhe 2 439 652 lekë të ardhura nga paga. Po ashtu, Blushi deklaron 1 987 942 lekë të ardhurat nga obligacionet, 3 883 093 lekë të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere, 2 040 000 lekë të ardhura nga qerja e ambientit në pronësi të vajzës, Natali Blushi etj.

***PASURIA E KRERËVE TË PARTIVE TË VOGLA PËR VITIN 2016***

**Nard Ndoka, kreu i PDK**

Blerja makine në vlerën 85 mijë euro, 35 mijë euro marrë hua, 33 mijë euro kalim nga paga, 4 mijë euro kalim nga llogaria personale. Dy llogari bankare, 1 040 euro. Llogari në lekë, 194 410 lekë. Pakësim i llogarive në shumat, 24 151 lekë, 339 180 lekë dhe 21 USD. Dhënë hua subjektit Last Minute Albania, 4 100 euro. Të ardhura nga paga, 3 187 555 lekë. Të ardhura nga llogaria, 199 322 lekë. Të ardhura nga bashkëshortja si specialiste pranë Ministrisë së Bujqësisë, 616 489 lekë. Kredi në vlerën, 2 000 000 lekë, shlyer 176 922 lekë. Hua shtetasit...., 35 mijë euro. Kozeta Ndoka, shtesë në llogarinë rrjedhëse, 9 489 lekë. Djali Evis Ndoka, shtesë në llogarinë rrjedhëse, 215 115 lekë. Të ardhura si specialist në Bashkinë e Tiranës, 708 507 lekë. Kontratë për blerje apartamenti dhe garazh, shlyer 34 944 euro, detyrimi i mbetur 159 400 euro. Stela Ndoka, vajza, llogaria rrjedhëse, 788 lekë. Të ardhura si speciale pranë KMSHC, 565 330 lekë.

**Shpëtim Idrizi, kreu u PDIU**

Interesa nga depozita, 2 402 euro. Interesa nga depozita 7 000 000, 700 319 lekë. Depozitë në emrin e bashkëshortes, gjendja, 297 509 lekë. Llogari rrjedhëse në emrin e bashkëshortes, 1 026 lekë. Depozitë në emrin e bashkëshortes, 10 mijë euro. Depozitë në emrin e djalit Denion Idrizi, 10 mijë euro. Kartë krediti në emrin e bashkëshortes, minus 162 385 lekë. Të ardhura nga paga, 1 901 571 lekë. Të ardhura nga shërbimi i konsulencës së bashkëshortes në 'Future University of Tirana', 15 mijë euro. Të ardhura nga paga e bashkëshortes si këshilltare në kabinetin e Guvernatorit të BSH, 2 529 655 lekë. Vijon shlyerja e kredisë marrë në vitin 1998, në shumën 30 000 000 lekë, detyrimi, 1 444 lekë. Vijon shlyerja e kredisë, 4 372 lekë.





**Agron Duka, kreu u Partisë Agrare Ambintaliste**

Gjendja e llogarisë së pagës, 734 873 lekë. Gjendja e llogarisë së kartës së kreditit, 39 602 lekë. Të ardhura dhe përfitime si deputet, 3 215 844 lekë. Bashkëshortja Fatbjana Duke, të ardhura nga paga në shoqërinë 'A.I.B.A KOMPANI", 41 800 lekë. Vajza, Eva Duka, llogaria e pagës, 99 264 lekë. Paga si administratore në shoqërinë 'ECO MARKET', 1 062 144 lekë. Andi Duka, djali, paga si specialist në shoqërinë 'ECO MARKET', 600 000 lekë.

**Vangjel Dule, kreu i PBDNJ**

Kursime nga të ardhurat personale, 4 800 euro. Të ardhura nga paga, 2 944 241 lekë. Të ardhura nga paga e bashkëshortes, arsimtare në Greqi, 6 568 euro. Kredi për shtëpi, shlyer 4 790 euro, mbetur 18 mijë euro.

**Ben Blushi, kreu i LIBRA-s**

Llogaria rrjedhëse e pagës, pakësuar me 2 827 720 lekë. Obligacioni, pakësuar me 29 000 000 lekë. Depozita në euro, pakësuar me 5 884 euro. Llogari për pagesë me kartë, pakësuar me 569 lekë. Llogari në USD, shtuar me 299 980 USD. Llogari në USD, pakësuar me 300 000 USD. Pjesëmarrje në obligacione, shtuar me 300 000 USD. Kreditime për të drejtën e autorit nga UET, shtuar 1 648 091 lekë. Të ardhura nga paga, 2 439 652 lekë. Pagesa për të drejtën e autorit nga UET, 3 000 000 lekë. Të ardhurat nga obligacionet në lekë, 1 987 942 lekë. Të ardhura nga puna e bashkëshortes si notere, 3 883 093 lekë. Të ardhura nga qerja e ambientit në pronësi të vajzës, Natali Blushi, 2 040 000 lekë. Vijon shlyerja e kredisë, shlyer 288 000 lekë, detyrimi i mbetur, 2 013 796 lekë. Eva Blushi, bashkëshortja, kredi, shlyer 282 077 lekë, mbetur 537 288 lekë. Vajza Natali Blushi, llogari bankare, 5 438 lekë.

**Dashamir Shehi, kreu i LZHK**

Gjendja në llogarinë rrjedhëse, 30 000 lekë. Gjendja aktuale në llogarinë rrjedhëse, 12 277 lekë. Të ardhura neto nga interesat e bonove, 74 415 lekë. Depozitë 12-mujore me vlerë 10 mijë euro -Zotërojmë si familje prona të konsiderueshme, të cilat janë depozituar pranë komisionit të kthimit të pronave. Të ardhura vjetore nga paga si deputet, 2 337 939 lekë. Të ardhura nga paga e bashkëshortes si drejtore e Përgjithshme e AMF, 3 775 882 lekë. Të ardhura mujore nga botime dhe publike në gazeta dhe periodike të ndryshme, 200 euro në muaj.

**Fatmir Mediu, kreu i Partisë Republikane**

Llogari rrjedhëse e pagës së bashkëshortes, 6 110 lekë. Llogari e pagës, 110 832 lekë. Të ardhura nga paga si deputet, 2 545 160 lekë. Të ardhura nga paga e bashkëshortes si përgjegjëse sektori në Ministrinë e Energjetikës, 864 744 lekë. Të ardhura nga paga e bashkëshortes si anëtare e Këshillit Mbikëqyrës panë Ministrisë së Ekonomisë, 53 904 lekë. Të ardhura të vajzës nga kompania AGROBLEND, 1 375 877 lekë. Kredi në shumën, 284 524 lekë. Kredi, detyrimi i mbetur, 120 mijë euro, shlyer 13 mijë euro. Kredi, detyrimi i mbetur, 2 494 euro, shlyer 3 175 euro.

**Eduart Ndocaj, kreu i partisë Bashkimi Demokristian Shqiptar**

14 apartamente në Shëngjin, me sipërfaqe 725 m2, dy bodrume me sipërfaqe 234 m2, me vlerë 32 580 220 lekë. Shtëpi private në Shëndëlli të Sarandës, 600 m2 ndërtesë, plus 1200 m2 truall, 100 mijë euro. Dy dyqane në Lezhë me sipërfaqe 259 m2, me vlerë 11 360 000 lekë. Apartament në Lezhë me sipërfaqe 69 m2, me vlerë 2 000 000 lekë. Kontratë për ndërtim apartamenti tek Fresku në Tiranë, 420 euro / m2. Kontratë për ndërtim bodrumi tek Fresku në Tiranë, 666 m2, për 300 euro / m2. Kontratë për ndërtim apartament tek Misto Mane në Tiranë, 94 m2, për 380 euro / m2, gjithsej 496 160 euro. Truall në Shëngjin, 1 200 m2, 2 000 000 lekë. Dyqan në Lezhë, 57 m2, 2 280 000 lekë. Tokë e trashëguar, 16 mijë m2. Apartament 480 m2, në Solaro në Itali, 650 mijë euro. Apartament 100 m2 dhe truall 2 000 m2, në Bergamo në Itali. Apartament në Solaro në Milano, me sipërfaqe 180 m2, me dy garazhe për makinash, me vlerë 300 000 mijë euro. Rroga si deputet, 122 901 lekë, 34 035 lekë karburant, 17 000 lekë telefon, 13 600 lekë komisione parlamentare. Kredi në një bankë në Lezhë, 325 mijë euro. Kredi në Itali, 185 mijë euro, detyrimi i mbetur 130 mijë euro. Kredi në Milano, 435 mijë euro, detyrimi i mbetur 300 mijë euro. Bashkëshortja, dy dyqane në Lezhës me sipërfaqe 259 m2, 10 360 000 lekë. Apartament në Lezhë, me sipërfaqe 69 m2, me vlerë 2 000 000 lekë

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Ligji i ri nuk e zgjidh çështjen e kthimit të pronave

**Nga Ben Blushi**

Sikur ceshtja e pronave te ishte zgjidhur keto dy dekada ndoshta sot do kishim nje kuptim tjeter per varferine per pasurine dhe korrupsionin.

Shqiperia do ishte nje vend me funksional,drejtesia do ishte me e besueshme,investimet ne bujqesi dhe turizem do ishin shtuar dhe te pakten 3000 jete do ishin kursyer.

Kjo eshte ne nje kuptim fatura e moszgjidhjes se ceshtjes se kthimit te pronave. Nese ka nje shtrese persekutimi i te ciles nuk ka mbaruar ata jane pronaret. Ata te cileve iu moren pronat, shtepite tokat dhe pasurite.

Nje pjese e madhe ende nuk i kane marre dhe sot. Shumica e atyre qe i vune keto prona nuk i gezuan dot. Ata vdiqen pa shijuar frytet e nje toke qe prodhon, apo te nje shtepije qe kthehet ne ndertim dhe rritet si pasuri.

Shumica prej nesh qe jemi ne kete parlament nuk kemi patur prona te konfiskuara nga shteti dhe kjo eshte arsyeja qe nuk e kuptojme sic duhet dhimbjen dhe trishtimin e nje jete te kaluar me kompleksin e zhveshjes nga prona.

Eshte edhe me e dhimbshme te mendosh se keta njerez u grabiten nga shteti dhe sot po pengohen serish shteti.

Qe ta kuptojme kete duhet te mendojme per nje cast, sikur shteti te kthehet serish kunder nesh. Sikur te gjitheve qe jemi ketu te na merren shtepite,pronat,tokat dhe pas 20 apo 30 vitesh ato te hyjne ne kalvarin e gjyqeve apo te pamundesise per ti kthyer dhe kompensuar financiarisht.

Imagjinoni sikur , pas 30 vitesh,niperit tuaj,te mos kene mundesi te trashegojne pronat dhe per me teper te rraskapiten edhe 20 vjet te tjera per ti marre ato.

Kjo do te thote te kesh shtetin kunder. Brezat qe vijne nuk do besojne se shteti mban anen e se drejtes dhe ekonomija do te deformohet nga shtremberimet dhe spekulimete tregut dhe te drejtesise se korruptuar. Prandaj une them se pronaret kane te drejte. Atyre duhet tu njihen dhe tu jepen pronat e tyre.

Ceshtja eshte si?

A ka toke dhe troje te mjaftueshme per tua kthyer? A ka mundesi financiare per ti kompesuar?

Nga shifrat qe kemi perpara del se jo. Nje pjese e madhe e tokave jane zene. Ne menyre te rregullt apo te paligjshme.

Kompensimi financiar me vleren e tregut shkon ne afro 30 miliarde euro qe do te thote se duhen te pakten 5 buxhete, pa rroga, pa investime dhe pa pensione per te kompensuar te gjithe ata te cileve u eshte bere kjo padrejtesi.

Nese shoqeria do te pyetej sot se pse duhen harxhuar 5 buxhete per te kompensuar pronaret sigurisht qe shoqeria do te ishte skeptike.

Ajo nuk paguan dot.

Perse duhet paguar padrejtesia me taksa?Pse duhet te paguajne te gjithe per te ndrequr nje gabim apo nje krim?Pse duhet te hiqen parate nga spitalet dhe shkollat nga rruget,energjia dhe bujqesia per te blere pronat qe shteti ua grabiti pronareve?




Natyrisht qe shoqeria kate drejte. Ajo smund te paguaje nje krim perjetesisht.

Mirepo ceshtja e prones nuk eshte nje ceshtje politike. Per mua eshte njeceshtje te drejte universale. Shoqeri te barabarte pa prona nuk ka. Ekonomi te zhvilluar pa pronesi nuk mund te kete. Ne e provuam dhe deshtuam me keq se kushdo tjeter ne planet.

Ceshtja eshte se ne 20 vjet ceshtja e prones nuk eshte konsideruar si nje e drejte universale njelloj si liria e fjales. liria e besimit dhe arsimimi, por si nje e drejte relative.

Shteti ta njeh, apo nuk ta njeh.

Ceshtja e prones ka qene dhe mbetet politike.

Mua me vjen keq sot qe pronaret duhet te jene serish nen kudhren e gjykimit tone.

A kemi ne te drejte ti kufizojme te drejtat e njeriut? Une mendoj se jo. Ne nuk duhet ta kemi kete te drejte. Ne nuk kemi te drejte ti mohojme askujt pronen dhe kthimin e saj.

Ne 20 vjet cudija ishte sesi pronaret u klasifikuan si torte elektorale. E drejta e tyre u politizua kur ne fakt duhet te ishte nje e drejte automatike qe buron nga kushtetuta. Atij qe i eshte marre prona duhet ti kthehet. Por kjo nuk ndodhi.

Dy aktet me te renda qe kane cenuar pronen ishin te dyja politike.

E para ligji 7501 dhe i dyti akti i legalizimeve.

Nuk them se nuk duhet te ishin kaluar,por te dyja duhet te ishin vene ne zbatim pasi te ishte mbyllur procesi i kthimit fizik te pronave. Nese kjo do kishte ndodhur, sot shoqeria nuk do ishte perballe nje fature financiare te paperballueshme e cila kercenon ekonomine e te pakten 30 viteve qe vijne.

30 miliarde euro eshte kjo fature. Ku mund ti gjejme?

Fatale eshte se, Partia Demokratike qe pretendoi se do ti mbronte pronaret beri me pak se kushdo per ta. Jo vetem qe ndau tokat e tyre ne menyre politike por inkurajoi zaptimin e pronave pa bere rishpendarjen e pronave te konsifiskuara.

Partia Demokratike ndertoi absurdin me te madh politik te pluralizimit:edhe me pronaret edhe me ata qe ua zaptuan pronat atyre. Por ky dem nuk eshte vetem iPartise Demokratike. Ky eshte demi i shoqerise per disa breza.

Partia Demokratike e ktheu te drejten e prones nga nje e drejte universale ne nje te drejte relative. Ne tete vite Partia Demokratike nuk beri dot nje ligj per pronat por ne fakt e amendoi, e qepi dhe shqepi mbi dhjete here ligjin e vitit 2004. Perfundimi i kesaj tollovije ligjore sot eshte trondites. Ne tete vjet qeveria e djeshme ka paguar me pak se 30 milione dollare per kompensimin e pronave cka eshte krejtesisht e paperfillshme dhe injoruese. E vetmja gje qe u be per dhjete vjet eshte postimi I dosjes se pronave. Zgjidhja u shty duke rritur faturen financiare dhe kostot per brezat.

E dini kush jane njerezit qe kane paguar me shtrenjte kete fature?

Jane ata qe nuk kane patur prona te konfiskuara nga shteti dhe ata qe nuk kane zaptuar asnje meter toke te cilen tashme e kane legalizuar. Keta jane shumica e popullsise. Ata kane paguar nje fature padrejtesije e cila sot shkon me shume se disa miliarde.

Sot serish ata jane perpara kesaj fature. Sipas ketij ligji duhet te paguajne te pakten 50 milione dollare ne vit per te kompensuar financiarisht padrejtesine qe shteti u ka bere pronareve te ligjshem.

Ky ligj,megjithese eshte me i guximshem sesa ajo qe ka ndodhur per tete vitet e shkuara, megjithate nuk e zgjidh ceshtjen e prones.

Ky ligj nuk e kthen pronen por vetem e kompenson ate.

Une mendoj se debati nese prona duhet kompensuar me vleren e tregut e sotem apo me vleren e tregut kur prona eshte konfiskuar mbetet ne thelb te ligjit.

Shqiperia nuk ka mundesi ta paguaje kete fature.

E megjithate une besoj se Republika jone mund te paguaje me shume se saka vendosur.

Jo vetem financiarisht por fizikisht.

Te gjitha pronat qe shteti ka sot i duhen dhene pronareve.

Kjo do ta ulte koston financiare dhe do clironte shtetin nga barra e padrejtesise historike. Pronaret mund te pranojne te mos marrin qind per qind ate qe u eshte marre por ata do te cliroheshin nga kompleksiipadrejtesise. Edhe me kete ligj ata besojne se padrejtesia vazhdon dhe do te vazhdoje.

Une besoj se shteti nuk kapse te jete pronar tokash dhe trojesh te cilat nuk iduhen. Hidrocentralet,puset e naftes,minierat,veprat publike, shkollat, spitalet nuk mund te kthehen dhe duhet te kompensohen por gjithshka tjeter nuk kapse mbahet.

Pronesija e tepert, e ndertuar mbi padrejtesi e rrenon nje shtet.

Nese nje njeri qe ka 1000 metra per tiu kthyer i jepen 200 dhe 800 te tjerat mbahen nga shteti per tu rishpendare, per tu privatizuar apo dhene me koncesion kjo eshte e padrejte. Perfat te keq ky ligj nuk e garanton kete marredhenie. Shteti serish mbetet pronari me i madh ne kurriz te pronareve te ligjshem.

Shteti nuk mund te ndertoje publiken mbi jopubliken.

Kjo e drejte qe shteti ia jep vetes nuk e ben ate me te besueshem dhe e fut ne rrugen e korrupsiont sic ka ndodhur keto vite kur tokat e pronareve jane blere apo pervetesuar nga njerez te tjere te cilet i gezojne sot padrejtesisht.

Prandaj them se ligji duhet te quhet ligj per kthimin e pronave dhe jo vetem kompensimin e tyre. Prona duhet ti njihet dhe ti kthehet atij qe i takon.

Thene keto jam I bindur se ky ligj nuk e zgjidh ceshtjen e pronave sepse ai nuk i kthen ato, duke e shtyre zgjidhjen per nje kohe te panjohur. Kostot e buxhetit rriten dhe konfliktet gjyqesore apo njerezore do te shtohen duke kalbur gjykatat dhe duke perkulur aftesine e shtetit per te investuar apo per te thithur investime te mjaftueshme.

Nese duhet te zgjedh mes qeverise dhe pronareve zgjedh pronaret.

Ata nuk jane problemi, ata jane viktima.

Nese duhet te zgjedh mes te drejtes dhe pamundesise, zgjedh te drejten.

E drejta e ben cdo te pamundur te mundur.

# Ta emërtosh Marrëveshjen Rama-Basha bashkëqeverisje është mjerane

Nga Fitim Zekthi




Për një pjesë të njerëzve, sidomos në media dhe politikë, marrëveshja Rama-Basha ishte një marrëveshje për bashkëqeverisje, për të shkatërruar Ilir Metën dhe partitë e vogla, për të qeverisur bashkë edhe pas zgjedhjeve etj. Teoritë konspirative nuk janë produkt i natyrës njerëzore. Kushtet, gjendja sociale apo çfarëdolloj janë ato që i shtyjnë njerëzit drejt tyre. Ngjarjet e tmerrshme, si: krizat ekonomike, vrasjet e rëndësishme, një aksident, një humbje domethënëse e diçkaje prej dikujt i bëjnë njerëzit që janë të trembur dhe të zemëruar prej këtyre ngjarjeve që të kërkojnë dikë për të fajësuar. Mendja njerëzore në shumë raste shtyhet të mendojë se kurdo që ndodh diçka e keqe, ajo ndodh sepse dikush i keq do që ajo të ndodhë. Teoritë konspirative përhapen veçanërisht brenda komunitetesh të izoluara, rrjetesh sociale, përfshirë dhe ato online. Cass Sunstein, një filozof i njohur amerikan i të drejtës dhe ligjit thotë se njerëzit i pranojnë teori të tilla kaq pa lidhje me të vërtetën për shkak të dyshimeve të tyre dhe për shkak të natyrës së tyre paranojake. Askush nuk e di se çfarë kanë biseduar Rama dhe Basha fshehtas dhe sa kohë askush nuk e di atëherë ne duhet të gjykojmë mbi faktet publike. Marrëveshja vinte pas 90 ditësh protestë, pas kërcënimeve të opozitës se nuk do të hynte në zgjedhje dhe pas kërcënimit të qeverisë se do të shkonte në zgjedhje e vetme dhe se do ta zhdukte opozitën duke sajuar një opozitë me partinë e z. Topi, z. Bojaxhi, z. Blushi etj. Marrëveshja vjen pas dështimit të negociatave të drejtuara nga zyrtari i partive popullore europiane McAllister dhe pas pafuqisë së qeverisë për të mbajtur zgjedhje në Kavajë. Deri në momentin e takimit të Ramës dhe Bashës konflikti politik mes palëve ishte shumë i lartë, më i larti ndoshta i katër viteve të fundit. Pavarësisht se Basha kishte thënë se zgjedhje me Ramën kryeministër nuk do të ketë dhe pavarësisht se Rama kishte thënë se krizës së çadrës që ishte krizë e vetë PD-së nga frika e humbjes dhe e vettingut ai nuk do t'i dorëzohej, ata arritën një marrëveshje thuajse historike. Në letër marrëveshja krijon mundësi të rralla që qeveria të mos përdoret në fushatë, që paratë publike të mos përdoren në fushatë, që dekriminalizimi të ndodhë, që të gjurmohet paraja e pistë, të vëzhgohet dhe kapet përdorimi i parasë së drogës për të blerë vota etj. Marrëveshja iu jep mundësinë partive të hyjnë vetëm në zgjedhje dhe të matin fuqinë e tyre pa iu dashur mbulimi pas koalicioneve. Marrëveshja mund të jetë e kritikueshme në shumë pika, mund të kishte elemente më shumë kontrolli ose mund të ishte edhe më e keqe. Shumë njerëz të PD-së ose votues të saj do të donin që kryeministri të jepte dorëheqjen, zgjedhjet të bëheshin në vjeshtë dhe mundësisht Rama të caktonte dikë tjetër si kandidat për kryeministër. Por marrëveshja mund të ishte më e keqe, kryeministri mund të rrinte vetëm te paketa McAllister, te largimi i katër ministrave dhe te mbajtja e disa mjeteve qeveritare, si: OSHEE, ALUIZNI etj., që mund të përdoreshin në fushatë. Marrëveshja ka tri lloje kundërshtarësh. Një pjesë janë mbështetës të PS dhe PD-së. Mbështetësit e PS thonë se Rama shiti pushtet, hyri në bashkëqeverisje. Këta mendojnë se iu ndodhi diçka e keqe, që Rama u dorëzua, që hyri në bashkëqeverisje etj. Funksionarë, mbështetës apo votues të PD-së gjithashtu fajësojnë Bashën se bëri marrëveshje me Ramën, i la pushtetin Ramës, goditi LSI-në, do të ketë bashkëqeverisje. Në këtë grup një pjesë e shohin veten larg pushtetit, pa pushtet. Ata kanë shtysa dhe inate personale ndaj Bashës. Grupi i dytë i atyre që flasin për konspiracion janë LSI-ja, PDIU-ja, Topi, Blushi, Bojaxhi. Çuditërisht ato fajësojnë Bashën më shumë se sa Ramën. Moslejimi i koalicioneve me të vërtetë mund të penalizojë, ato janë viktima të lojës së tyre pa principe. LSI i besoi shumë vetes dhe aftësisë së liderit si politikan i hollë, që di ta dredhë, që është mjeshtër dhe shumë i zoti dhe që në çdo rast do të dinte të fitonte. Në fakt dhe kjo është çështje filozofie e provuar që në fillimet e historisë së njeriut, LSI duhet ose t'i kthente faqen Ramës, t'i dorëzohej, të pranonte një rol minor të një partie të vogël dhe të mesme ose ta mundte. Lufta e saj me PS nuk do të shuhet kurrë deri sa njëra (LSI) të kthejë faqen ose edhe zhbëhet krejt. LSI duhet me kurajë të shkonte në koalicion me PD dhe t'i linte idiotësitë e "mbi palëve", e "faktor përbashkues" etj., dhe të përpiqej ta mundte Ramën. Basha nuk i ka bërë asgjë dhe nuk i ka asnjë detyrim, për më tepër kur LSI nga "zgjedhje pa opozitën nuk" shkoi e heshti duke harruar ç'tha. Topi është e kotë të flasim, duhet të shkonte në çadër. Bojaxhi po ashtu. Ideja se janë opozitarë e të djathtë dhe nga ana tjetër hyjnë në zgjedhje të kapin grimca të dhëna nga shumica për të legjitimuar zgjedhjet pa opozitën është qesharake dhe do ta vuajnë. Nuk iu ka faj Basha dhe as ka konspiracion. Edhe Blushi duhet të shkonte në çadër. PDIU është diku mes LSI dhe partive të vogla dhe duhet të zgjidhte me kurajë të shkonte në prehrin e Ramës ose në opozitë. Fajësimi i Bashës është qesharak. Ka edhe një grup tjetër që kundërshtojnë marrëveshjen dhe flasin për bashkëqeverisje dhe konspiracion. Këta janë disa analistë të njohur si Bushati dhe Lubonja etj., të cilët duhen vlerësuar për qëndrimet pasi nisen nga një qasje ideore ndryshe nga disa analistë të tjerë që janë kundër sepse janë zgjatime të partive ose interesave. Bushati dhe Lubonja mendojnë se sistemi është në krizë të thellë, se ai duhet shkulur nga rrënjët, se një grup politikanësh dhe biznesesh kontrollojnë vendin, paratë dhe vendimmarrjen. Së pari, këta nuk ishin në çadër dhe nuk ka kuptim t'i kërkojnë Bashës të mbajë çadrën hapur dhe t'i shkojë në fund shkuljes së sistemit. Së dyti, thelbi i së djathtës është siç thotë Peggy Noonan, ish-këshilltare e presidentit Reagan dhe një nga mendjet më të mprehta konservatore sot, gjetja e mënyrave për të bërë përpara sa të mundesh brenda realitetit pasi e ke njohur mirë atë dhe mundësitë që ke. Në këtë kuptim Basha ka vepruar si i djathtë. Në kushtet ku ishte ai dhe vendi nuk kishte asgjë më shumë për të marrë dhe fituar. Zgjidhja tjetër, ajo e vajtjes së vendit në zgjedhje pa opozitën do të ishte e frikshme. Vendi nuk do të qeverisej, PD do të hynte në një luftë të gjatë mbijetese dhe protestash, grevash urie apo lidhjesh me litarë para parlamentit, gjë që do ta dobësonte atë dhe qeverinë ndoshta. Më e keqja mund të ishte përplasje për shkak të frustrimit dhe rrugë pa krye për qeverinë dhe PD, por sidomos njerëzit. Tezat e Lubonjës, të cilat janë më të elaboruara flasin për një elitë të korruptuar dhe një popull të mirë, ato e ndajnë shoqërinë në këto dy grupe dhe kjo është problematike. Tezat e Lubonjës denoncojnë të vërteta dhe kjo është një e mirë e tyre, por ideja e çuarjes në fund, e shkuljes së sistemit të kontrolluar nga elita nuk dihet ku na çon. Marrëveshja ishte më e mira në këto momente.

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Marrëveshja Rama-Basha dhe emrat e Qeverisë Teknike. Zgjedhjet parlamentare më 25 qershor

**ËSHTË SHPËRNDARË MARRËVESHJA E PLOTË MES KRYEMINISTRIT TË SHQIPËRISË, EDI RAMA, DHE KREUT TË OPOZITËS SHQIPTARE, LULZIM BASHA. MARRËVESHJA U BË PUBLIKE PËR MEDIA NGA PARTIA DEMOKRATIKE. DETAJET JANË SI MË POSHTË.**

**MARRËVESHJE POLITIKE 18 MAJ 2017**

Palët në këtë marrëveshje shprehin mirënjohjen dhe falenderimin për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian për kontributin e tyre në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri si dhe në mënyrë të veçantë, për zgjidhjen e situatës politike për zgjedhjet e vitit 2017.

Palët konfirmojnë vullnetin e tyre për dialog të drejtpërdrejtë si shprehje e domosdoshmërisë për një nivel të ri të dialogut politik në vend. Në këtë kuadër, palët angazhohen për institucionalizimin e dialogut mes kryetarit të mazhorancës dhe kryetarit të opozitës.

Angazhimi i palëve për zgjedhje me standarte demokratike do të jetë pjesë thelbësore e kontributit të përbashkët dhe të vazhdueshëm të palëve në kuadër të çeljes së negociatave dhe perparimit të vendit në procesin e integrimit europian të Shqipërisë.

**A. ZGJEDHJET**

*1. Presidenti i Republikës dekreton datën e re të zgjedhjeve më 25 qershor 2017.*

*2. Regjistrimi i menjëhershem i partive politike të opozitës. Regjistrimi i listave shumemërore të partive politike të opozitës brenda datës 26 Maj 2017.*

*3. Listat e zgjedhësve*

*a. Përfshirja në listat e zgjedhësve e zgjedhësve të rinj që votojnë në datën e re të zgjedhjeve.*

*b. Dhënia e aksesit opozitës në informacionin e mbledhur nga projekti i Adresave dhe çështjet të tjera të lidhura me zgjedhësit, nëpërmjet auditeve të KQZ-së.*

*4. Mbështetje KQZ-së për përgatitjen e materialeve zgjedhore.*

*5. Plotësimi i komisioneve zgjedhore dhe grupeve të numërimit.*

*6. Zgjedhjet e pjesëshme për bashkinë e Kavajës, do të zhvillohen në të njëjtën ditë me zgjedhjet e përgjithëshme.*

*7. Pezullimi i çdo iniciative për kontrata të përkohëshme në nivel qëndror dhe vendor.*

*8. Mbështetje ndërkombëtare për forcimin e montorimit te listës së zgjedhësve.*

*9. Mbështetje ndërkombëtare për KQZ- për ngritjen e linjave telefonike të ndihmës për vezhgimin dhe shqyrtimin e ankesave mbi ligjin e shërbimit civil dhe blerjen e votës.*

**Kryeministri Edi Rama pranoi propozimet e kryetarit të Partisë Demokratike, Lulzim Basha për 7 emrat e rinj të qeverisë së tij dhe i dërgoi për dekretim në Presidencë.**

Rama dhe Basha u takuan në mbrëmje në mjediset e Pallatit të Kongreseve dhe përmbyllën një nga pikat e marrëveshjes që ata arritën të enjten në orët e para të mëngjesit.

Emrat teknikë të propozuar nga opozita janë: për postin e**zëvendëskryeministrit Ledina Mandia**, ish-Avokate e Shtetit në kohën e qeverisë "Berisha" dhe aktualisht këshilltare e Presidentit.

Për postin e **ministrit të Brendshëm, Dritan Demiraj**, gjeneral, ish-komandant i trupave speciale dhe ish-pjesëtar i Forcave të Armatosura në misionet jashtë vendit, aktualisht me banim në SHBA.

**Ministre e Financave, Helga Vukaj**, drejtoreshë e përgjithshme në KLSH dhe ish-zv/drejtoreshe e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në kohën e qeverisë së djathtë.

**Ministër i Drejtësisë, Gazmend Bardhi**, këshilltar ligjor i Partisë Demokratike.

**Ministër i Arsimit dhe Sportit, Mirela Karabino**, pedagoge në fakultetin e Shkencave Sociale, një nga personat që ka folur në çadër gjatë protestës 3-mujore.

**Ministër i Shëndetësisë, Arben Beqiri**, kirurg, pedagog dhe ish-zv/rektor i Universitetit të Mjekësisë në Tiranë.





Ministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, **Xhuljeta Kërtusha** me profesion inxhiniere, aktualisht menexhare e "Statkraft" dhe më herët drejtoreshë e CEZ.

Po ashtu, Partia Demokratike ka propozuar **Klement Zgurin** për postin e Kryetarit të **Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, prej shumë vitesh anëtar i këtij institucioni, ndërsa avokaten **Erinda Ballancën për kreun e Avokatit të Popullit**.

Emrat kaluan për votim në seancën e jashtëzakonshme të së hënës, që u mblodh në orën 18:00 me kërkesë të Kryeministrit.

Kuvendi njoftoi të hënën se u vu në zbatim marrëveshja Rama-Basha, ku do të do të miratohen ndryshimetnëqeveri,paketapërzgjedhjet,"Vettingu" si dhe kreu i ri i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ndërkohë, Presidenti Nishani ka ndryshuar datën e zgjedhjeve si rrjedhojë këtij pakti. Dekreti i ri zyrtarizon 25 qershorin si datën e darkordësuar mes Kryeministrit dhe liderit të opozitës, ku njëherësh do të mbahen edhe zgjedhjet për kryetarin e ri të Bashkisë së Kavajës.

**C. PARLAMENTI**

*1. Votimi i organeve të vettingut.*

*2. Votimi i dekreteve për anëtarët e rinj të Këshillit të Ministrave.*

*3. Ndryshim i Kodit Penal për forcimin e politikës penale nëpermjet ashpërsimit të sanksioneve, krijimit të veprave të reja penale, kthimin e shitblerjes së votës në vepër korrupsioni.*

*4. Forcimi i kuadrit ligjor të financimit të partive politike nëpërmjet rregullimit dhe kufizimit të shpenzimeve zgjedhore, përfshirë ato materiale, kostove dhe transparencës në lidhje me to.*

*5. Përmirësimi i standarteve të pasqyrimit të fushatës elektorale në media.*

*6. Votimi i anëtareve të Këshillit të Ministrave, anëtareve të organeve të vettingut dhe i legjislacionit të parashikuar në këtë marrëveshje, do të kryhet në të njëjtën seancë të jashtëzakonshme të parlamentit.*

**D. ORGANET E PAVARURA**

*1. Kryetari i KQZ, propozim i opozitës.*

*2. Avokati i Popullit, propozim i opozitës.*

**E. REFORMAT**

*1. Reforma Kushtetuese (me fillimin e legjislaturës së re).*

*2. Reforma zgjedhore (me fillimin e legjislaturës së re).*

*3. Futja e teknologjive elektronike në procesin e identifikimit votimit dhe numërimit për zgjedhjet pasuese.*

*4. Reformim tërësor i sistemit të prokurimeve publike dhe auditimit të shpenzimeve publike.*

**F. MASA TE TJERA**

*1. Dekriminalizimi. Largimi dhe parandalimi i personave me rekorde kriminale nga mbajtja e posteve publike.*

*2. Partitë politike angazhohen publikisht për ekzaminimin e fortë mbi listat partiake.*

*3. KQZ ekzaminon kandidatët nëpërmjet personelit shtesë me mbështetje ndërkombëtare (të plotësuar në përputhje me ligjin nr 138/2015 për garantimin e integritetit të funksionarëve publik ).*

*4. Administrata Publike. Marrja e masave për ndalimin e përdorimit në favor të subjekteve zgjedhore të mjeteve, pronave dhe të burimeve njerëzore të administratës publike si dhe kundër çdo forme presioni ndaj punonjësve të administratës publike në çdo nivel.*

*5. Narkotikët. Forcimi i luftës kundër narkotikëve, nëpërmjet pjesmarrjes së opozitës në Task forcën Kombëtare të luftës kundër narkotikeve*





U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Ilir Meta: Marrëveshja Rama-Basha. Koalicionet. LSI dhe Presidenca

## INTERVISTA E KRYETARIT TË KUVENDIT, Z. ILIR META NË EMISIONIN "ZONË E LIRË" TË GAZETARIT ARJAN ÇANI NË TV KLAN

**z.Meta, më dukesh mua, apo je pak i mërzitur?**

Jo, unë jam shumë në formë.

**Po ç'është kjo qetësi? Ti e ke pasur gjithmonë…**

Padyshim që është detyra e politikanëve të jenë gjithmonë të qetë, aq më tepër kur qetësia na duhet, në këto kohë.

**Edhe tani që pas gjithë kësaj situate duket sikur partia që ju keni drejtuar në kaq shumë vite, me kaq shumë mund, me kaq shumë sakrifica, me shumë dashuri, duket sikur i futet një kalvari të ri vuajtjesh… Ajo që ndodhi së fundmi është përsëritja në një farë mënyre por në forma të tjera e paktit që u bë midis z. Berisha dhe z. Rama në 2008-n… Apo jo?**

Së pari, është e rëndësishme që z. Rama dhe z. Basha i dhanë fund një kalvari vuajtjesh qytetarëve shqiptarë për disa muaj, në mënyrë të panevojshme dhe artificiale. Dhe i dhanë mundësi vendit të jetë më i qetë dhe të shkojë më në fund në zgjedhje normale, gjithëpërfshirëse, ku opozita do të marrë pjesë.

**Ishin artificiale arsyet e krizës?**

Padyshim që ishin artificiale sepse kjo zgjidhje që u bë para dy ditësh mund të ishte bërë para dy muajsh kur erdhi përfaqësuesi i PPE-së, z. McAllister. Mund të ishte bërë edhe më përpara nëse do të kishte vullnet të mirë për të dhënë më shumë besim për zgjedhjet.

**z.Meta përse, sipas teje, nuk u bë kjo përpara 1 muaji?**

Nuk dua të bëj gjykatësin dhe analistin sepse nuk është kjo detyra ime. Mund t'ju them që përpjekjet e mia, edhe si kryetar i Kuvendit në atë kohë, edhe të LSI-së kanë qenë maksimale që kjo gjë të ndodhte prej kohësh, në mënyrë që vendi të mos pësonte atë stres por edhe atë pasiguri dhe dëmtim të imazhit. Le të mos harrojmë, kemi hyrë në sezonin turistik, përveç shumë faktorëve të tjerë, sepse nuk ka vetëm zgjedhje në këtë vend. Ka edhe ekonomi, ka edhe turizëm, ka edhe kulturë, ka edhe sport.

**Në turizëm nuk është se po bëhet ndonjë nam i madh, por le të themi që ka…**

Turizmi është një dinamikë pozitive, në rritje dhe me turizmin jetojnë dhe përfitojnë me mijëra familje shqiptare.

**z.Meta, të gjitha këto janë interesi publik, apo jo, dhe unë e di që ti ke qenë një politikan i përgjegjshëm. LSI në këto momente është në një farë mënyre e paralizuar. Dhe jo vetëm LSI-a, por edhe partitë e tjera sepse nuk patën mundësi të bënin koalicion…**

Përmendët edhe 2008-n, përmendët edhe koalicionet. Së pari, duhet të kemi parasysh që historia nuk përsëritet dy herë njësoj. Në qoftë se në 2008-n u përjetua si tragjedi, tani të gjithë e përjetojnë si komedi. Së dyti, janë dy realitete krejt të ndryshme. Dhe së treti, LSI-a nuk dëmtohet nga çdolloj manovre, apo ku di unë, për çështjen e koalicioneve, për arsye sepse të gjitha forcat politike në këtë rast, garojnë në mënyrë të barabartë. Dhe në këtë raport, sikurse ju besoj e shikoni apo e ndieni, ndihet tepër e sigurt për të dalë forcë e parë në këto zgjedhje, kështu që nuk ka asnjë arsye pse të dëmtohet.

Ndoshta mund të dëmtohen disa parti të reja të cilat ende nuk janë shtrirë në terren dhe mund të kishin përfaqësim më të drejtë, por përsëri kjo nuk është përgjegjësi e LSI-së në këtë rast.

**Megjithatë, nga kjo marrëveshje, po të ishte mundësia e koalicionit e hapur, LSI do të shkonte në koalicion me një parti tjetër të madhe?**

LSI-ja do të krijonte çdolloj koalicioni që do ta bënte garën më të shëndetshme dhe më demokratike.

**Pra nuk do të ishit kundër koalicioneve parazgjedhore, apo jo?**

Nuk kemi qenë asnjëherë kundër koalicioneve por me çdo rast do gjykojmë për koalicionet në varësi të rrethanave.

**Një ditë para se të bëhej kjo marrëveshje, LSI-ja dhe PDIU-ja, të dyja me përfaqësuesit e vetë, Petrit Vasili, kryetari i ri i LSI-se dhe Shpëtim Idrizi, të paktën dy parti që janë në koalicion me Ramën dhe PS-në, dolën dhe në një fare mënyre i thane Ramës se ne e pranojmë paketën "Mc Allister +", PD-ja dhe Basha, për surprizën e të gjithëve tha që ne e pranojmë pa kushte votojmë dhe Vettingun. Rama mbeti vetëm. Nuk e menduat të mërkurën që duke e vënë te cepi i murit Ramën ai do të bënte këtë që bëri? Të kapte Bashën "tete-a-tete" dhe të dilte kjo marrëveshje. E bëj këtë analizë. Ju nuk dinit asgjë si bashkëkryetar i koalicionit. Dhe Petrit Vasilin, kryetarin e LSI, ministrin e Drejtësisë e hoqën pa dijeninë e tij.**

Po e dramatizoni. Që kur lindi kriza LSI ka pasur një qëndrim Kristal të qartë. Duhet dialog. Opozita ka të drejtë për çështjen e drogës. Ka të drejtë për çështjen e dekriminalizimit.

**Pra, kriza nuk ishte artificiale?**

Tejzgjatja e krizës dhe kërkesat, që ishin jashtë çdo logjike, sidomos qeveri teknike, votim elektronik, bërja e zgjedhjeve në dhjetor etj., ishin tërësisht të pajustifikuara, por këto çështje, të mësipërmet, ishin çështje që qëndronin.

Kur situata po acarohej më tej, LSI bëri propozimin që qeveria duhet të krijojë qeveri besimi për zgjedhjet, pra mund të jetë dhe kjo qeveri që është.

Praktikisht kështu ndodhi. Edi Rama është kryeministër dhe z. Basha propozoj disa ministra teknikë në disa ministri.

**I ka propozuar?**

Do i propozojë. Sipas marrëveshjes do i propozojë PD dhe kjo është qeveri që ka tani besimin edhe të PD, edhe të gjithë partive të tjera.

**Edhe të LSI?**

Po natyrisht që e ka. LSI nuk ka shqetësime kaq shumë për çështjen e zgjedhjeve.

**Ç'është kjo fushatë e çuditshme kur jeni të tre në qeveri. Ç'do të thoni në fushatë?**

Secili do të japë alternativën e vetë.

**Do të jetë një fushatë pozitive?**

Nuk e di, besoj që LSI gjithmonë bën fushatë pozitive. Nuk shan. Nuk anatemon. Nuk denigron. Nuk arreston njeri për fjalime. Nuk fut njeri në burg për fjalime. Ka fushatë shumë të qetë, flet për rininë, flet për problemet e arsimit, probleme sociale.

**Kush e bën këtë?**

Nuk thashë kush e bën, por LSI bën gjithnjë fushatë pozitive. Edhe ditën e mërkurë z. Vasili bëri një deklaratë dhe tha LSI i qëndron pikë për pikë paketës Mc Allister dhe kjo do zbatuar pike për pike dhe ka thënë edhe tjetrën se është e gatshme dhe të rikthejë apo të vërë në dispozicion postin e Presidentit, që ishte pjesë e paketës Mc Allister. Pra, LSI është gati të bëjë çdo sakrificë. Ndërkohë që ne mandatet e ministrave dhe përfaqësuesve politik i kishim vënë në dispozicion me kohë për të zgjidhur këtë krizë, për të dhënë një mirëbesim për zgjedhjet.

**Unë dua të di nga ty, Edi Rama pse hoqi vetëm Petrit Vasilin sepse ju keni edhe tre ose katër ministra të tjerë?**

Kjo është një çështje që është diskutuar atje.

**E ka larguar Basha?**

E ka larguar besimi që ka kërkuar opozita te qeveria Rama për zgjedhjet dhe ne duhet ta japim këtë besim.

**Qeveria Rama- Meta? Se ju jeni në qeveri akoma? Tani është qeveria Rama-Basha-Meta?**

Maksimumi mund të quhet Rama -Vasili.

**Unë dua që në këtë studio të më thuash që nga kjo marrëveshje ti je i qetë,i lumtur, nuk të bënë përshtypje asgjë?**

Të them të drejtën kam qenë shumë i paqetë deri ditën kur u bë marrëveshja, ditën e mërkurë. Kam qenë i paqetë edhe më përpara, sepse kam menduar si do shkoj ky vend pa opozitën në zgjedhje.

**Tani që është edhe vend pluralist?**

Jo vetëm pluralist, por ku do shkoj ky vend…

**Pse hyre ti në zgjedhje?**

E para, ne kemi bërë të qartë që nuk bojkotojmë . Kemi bërë të qartë që zgjedhjet pa opozitën janë një farsë. Kemi bërë të qartë sepse është deklarata e Kryesisë së LSI-së dhe kemi thënë këtë gjë: që në rast se PS nuk bënë përpjekjet maksimale, ne nuk do të jemi në koalicion me të dhe ne nuk u regjistruam në koalicion me PS, se mund të regjistroheshim në koalicion me PS.

Ashtu sikurse mund të them që në rastin e delegacionit të PPE, qëndrimi i PS ishte më i hapur, sesa qëndrimi që u njoftuam ne i z. Basha, i cili nuk e kishte pranuar atë propozim në atë kohë, që ishte një propozim tepër i arsyeshëm sipas vlerësimit tim edhe sot.

**Kur thua për PPE e ke fjalën për Mcallister?**

Po, Mcallister.

**Ti dhe partia jote, para se të bëheshe President, pse vendose që të hyje në zgjedhje, pavarësisht me apo pa Ramën?**

Së pari, ne kemi respektuar disa procedura dhe disa afate, të cilat janë ligjore dhe Kushtetuese, siç është regjistrimi i partive, depozitimi i listave. Së dyti, unë në mënyrë të vazhdueshme edhe për çështjen e Presidentit, vendosi në paketën e mirëbesimit edhe për zgjedhjet si mundësi e mirë për opozitën dhe kemi punuar me këmbëngulje për të arritur këtë marrëveshje. Dukej qartë që opozita kishte një interes për ta përshkallëzuar krizën. Pra, në qoftë se opozita do të ishte me me këmbë në tokë, siç ndodhi para dy ditësh. Kjo situatë do të ishte zgjidhur përpara disa javësh.

**Pse Lulzim Basha u tërhoq dy ditë më parë?**

Ai ka bërë shumë mirë që është tërhequr. Sepse duhet të ishte tërhequr një muaj më parë. Më mirë vonë sesa kurrë.

**Çfarë e detyroi?**

Ndoshta ndjenja e përgjegjshmërisë. Çdo politikan në fund ka një ndjenjë përgjegjshmërie.

**Po, por ajo duhet të vijë nga një arsye e fortë?**

Një arsye e fortë, përveç faktorit ndërkombëtar, përveç të dërguarit të fundit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Yee dhe një faktor tjetër që unë e vlerësoj, kanë qenë partitë aleate të PD-së, z. Duka, z. Mediu, të cilët ishin shumë realistë dhe mendonin që u arrit sensibilizimi maksimal brenda dhe jashtë vendit për çështjen e zgjedhjeve dhe u dhanë disa garanci që asnjëherë më përpara nuk i ishin dhënë një opozite nga një mazhorancë shumë solide siç është ajo aktuale parlamentare. Natyrisht që nuk mund të çohej më tej një krizë e cila ishte duke sjellë një konfrontim me pasoja të pa parashikueshme. Pra unë mendoj se ndjenja e përgjegjësisë e solli këtë marrëveshje dhe kështu le të shpresojmë dhe besojmë se në të ardhmen mos i çojmë krizat në kufij të rrezikshëm por t'i parandalojmë ato dhe të ndërtojmë institucione të qëndrueshme.

**Për të qenë sa më etikë dhe sa më neutralë në këtë studio përballë teje më the arsyen se pse sipas teje Lulëzim Basha u tërhoq dhe u fut me Edi Ramën për 3 orë në një zyrë në parlament dhe bëri këtë marrëveshje. Tani më thuaj të lutem Z. Meta sipas teje pse Z. Rama nga një "McAllister +" dha një "Big Mac". Pse dha kaq shumë? Z, Rama dha më shumë se sa ishte parashikuar tek ajo paketë. Pse dhe në këmbim të çfarë?**

Kjo ishte një gjë pozitivë . Po që të hynin në zgjedhje.



**Po në zgjedhje ata hynin edhe me më pak. Z. Basha pranoi "McAllister plus". E z, Rama i dha "McAllister 5 plus".**

Unë nuk e kam të qartë këtë gjë por është shumë mirë. Rëndësi ka që vendi të shkojë në zgjedhje me opozitën.

**Mos mendo që unë po e paragjykoj këtë gjë.**

Jo, po e paragjykon por po e heton. Unë nuk kam instrumente për ta hetuar.

**Ju keni instrumentin logjik?**

Po, logjike është sepse të dy do të merrnin një përgjegjësi katastrofike nëse do ta çonin më tej këtë situatë.

Kështu që reflektuan dhe kjo është një gjë shumë e mirë. Pra, ata të dy për dy partitë që ata përfaqësojnë dhe për të gjithë vendin. Natyrisht që kjo nuk na ndihmon që të kemi zgjedhjet që duhet të kishim, sepse që të kemi zgjedhje që duhet të kishim rekomandimet e OSBE ODIHR duhet të kishin përfunduar para një viti dhe shumë çështje të tjera duhet të ishin zgjidhur me kohë.

Por sidoqoftë këto janë zgjedhje shumë më të mira sesa ato katastrofiket që do të kishim pa opozitën historike në këto zgjedhje. Dhe mendoj që kjo është pozitive.

**z.Meta jam kurioz të di se çfarë është ky instinkt që ju ka shoqëruar që kur keni qenë i ri farë, që para 22 vitesh e deri tani si ka mundësi**

**që të nesërmen e paktit Rama-Basha ju ishit tek Z. Berisha? Mediat ishin atje. Pse ai gjest? Çfarë mesazhi ishte?**

Doktori është pika ime e dobët dhe pika ime e fortë gjithmonë në kuptimin pozitiv të fjalës. Së dyti ajo ka qenë një ditë fare normale. Unë kam qenë në një drekë dhe natyrisht që kam patur edhe kënaqësinë të përshëndetem me doktorin dhe e kam vlerësuar rolin e tij për zgjidhjen e kësaj krize. Sepse duhet të jemi të sinqertë që doktori ka patur rolin e tij pozitiv.

**Pra ju po thoni që kjo është bërë në një farë mënyre pa bekimin e doktorit?**

Jo nuk po them se është bërë me bekim apo pa bekim sepse ato nuk janë çështjen e mia por unë mendoj se roli i tij duhet të ketë qenë pozitiv.

**Pra ju shkuat tek Z. Berisha për ta falënderuar?**

Po pa dyshim edhe për një vlerësim pse jo.

**Po ai çfarë ju tha?**

I përgjegjshëm si gjithmonë. Doktori nuk ka bojkotuar ndonjëherë.

**Dhe kaq?**

Po, ishte një kafe jo drekë. Dreka ishte me drejtues të LSI dhe disa kolegë të tjerë.

**Doktori ishte i qetë e dinte se çfarë ishte diskutuar?**

Jo, nuk diskutuam këto çështje.

**Punë është të informoheshit edhe ju?**

Nuk më duhej mua ai lloj informacioni. Ato janë çështje që do të bëhen. Rëndësi ka që PD-ja do hyjë në zgjedhje, ky ka qenë shqetësimi ynë. Se si do të bënim zgjedhje ne pa opozitën?! Ne nuk bëmë dot zgjedhje në Kavajë pa opozitën, do t'i bëjmë zgjedhjet në Shqipëri pa opozitën?!

**Tani kemi një zhvillim të ri, është në qeveri opozita tani…**

Kjo është një gjë akoma më e mirë. Tani ka mundësi të luftoj drogën. Ka mundësi të zbatoj dekriminalizimin. Ka mundësi që të kontrolloj shumë ministri ku mund të ketë ndërhyrje për qëllime elektorale. Kjo është një gjë shumë pozitive.

**Është thjesht në funksion të zgjedhjeve?**

Në radhë të parë në funksion të zgjedhjeve se kjo na duhet për momentin.

**Dëgjova Edi Ramën që fliste në Korçë dhe tha mos kujtoni se do të jenë ministra që të fusin njerëz në punë, por do të jenë thjeshtë disa kujdestarë dhe nuk kanë të drejtë të heqin njerëz nga puna. I dha garanci njerëzve të vet se do të jenë kujdestar. Pra përveç se janë teknik nuk kanë absolutisht asnjë të drejtë përveç të drejtës së vëzhgimit.**

Kjo është një gjë shumë e mirë. Po unë kam vetëm një pyetje. A e kupton se çfarë do të thotë një vend që shkon në zgjedhje pa opozitën?! Nuk ka rëndësi fare për një gjerman, për një amerikan, për një kanadez se e ka fajin Basha, e ka fajin Rama e ka fajin Meta. Për ata ky është një vend i dështuar që nuk bën dot zgjedhje me opozitën. Se kush e ka fajin për ata nuk ka rëndësi. Asht u sikurse edhe për qytetarët shqiptar, pavarësisht se kush e ka fajin, në radhë të parë për ta gjëja më e rëndësishme është qetësia, normaliteti dh siguria. Tani për ditën e zgjedhje dhe për të ardhmen. Dhe kjo garantohet vetëm me zgjedhje gjithëpërfshirëse. Për këtë tani duhet të jemi më të qetë.

**Pra ju mendoni që pas paktit dhe në qoftë se ky implementohet normalisht, dita e zgjedhjeve në Shqipëri do të jetë me varte një ditë ku vota nuk do të ketë presion, nuk do të ketë cenim të votës?**

Nuk e besoj sepse edhe kjo marrëveshje që është bërë, dhe përfshirja në qeveri e këtyre ministrave teknikë për këtë qëllim është. Edhe zëvendësimi i disa drejtuesve të disa institucioneve që kanë të bëjnë me sigurinë për këtë qëllim është. Besoj se qëllimi është i arritshëm dhe është i suksesshëm

**Petrit Vasili është një nga bashkëpunëtorët tuaj më të ngushtë. Në një farë mënyrë mori stafetën pasi ju do të shkoni President dhe u bë kryetar i LSI-së…**

Ai është kryetari i LSI-së sepse LSI-ja ka kryetar dhe zëvendëskryetar dhe nënkryetar. Ai ishte zëvendëskryetar dhe i takonte atij që t'u zgjidhte kryetar. U zgjidh në Konventë.

**Si ka mundësi që jeni kaq i qetë dhe nuk e mbrojtët Petrit Vasilin kur u shkarkua?**

Petriti është më i qetë se sa unë. Shqipëria me largimin e Petritin dhe vajtjen e një ministri teknik e ka qetësuar opozitën dhe ka marrë një garanci më shumë për zgjedhje të lira.

**Jam duke thënë se para se ta shkarkonte…**

Ju po thoni që Petritit nuk është i qetë. Unë ju them që është i qetë se unë me atë pak më parë u ndava.

**Në politikë kanë vlerë gjestet që do të thotë të lajmërosh tjetrin në momentin kur të heq?**

Edhe Ilir Meta edhe Petrit Vasili kanë mbi një muaj që thonë se ne i vendosim të gjithë postet e LSI-së në dispozicion të zgjidhjes politike. Pra, LSI ka Kryetar Kuvendi, 5 ministra. Këta ti marrë PD, ti marrë PS vetëm të gjendet një zgjidhje me PD që të krijohet një besim tek qeveria.

**Për këtë nuk ka pasur nevojë?**

Nuk ka asnjë arsye prandaj Petrit është i qetë.

**Të të uroj sot për postin e Presidentit apo…**

Më uro për LSI forcë e parë me 25 qershor pastaj kemi kohë për Presidentin.

**Gojët e liga thonë Ilir Meta se zyrën që ju i dorëzuat Petrit Vasilit nuk ia dorëzove ashtu siç mund të dorëzohet një zyrë por mbajtët një kopje çelësash dhe njerëzit thonë se nuk i dihet deri në datën 24 korrik në qoftë se të bien në qaftë më shumë seç duhet ju mund të jepni dorëheqje edhe si President. Keni thënë në një media…**

Ishte për çështjen e krizës sepse zgjedhja e Presidentit ishte një nga pikat tek paketa e McAllister dhe meqenëse u konsumua dhe mund të dilte problemi se ishte shkelur paketa McAllister dhe unë thash që e kthejmë këtë për të gjetur zgjidhje për zgjedhjet sepse zgjedhjet janë më të rëndësishme se sa Presidenti dhe ua kam thënë të gjithëve, më mirë një qytetar normal në një vend normal se sa President i një vendi që nuk bën dot zgjedhje me opozitën.

**Ka një problem. Dashuria jote më e madhe, përveç kalamajve dhe Monikës është LSI-ja. Si ka mundësi atëherë që fiks në këtë moment që LSI-ja do të futet edhe e vetme në zgjedhje në këtë furtunë të madhe dhe timonieri i saj, themeluesi i saj do e këtë të vështirë të bëj fushatë për LSI-në?**

Të gjitha të vetme do të futen. Nuk jam bërë ende president. Jam zgjedhur që të jem në 24 korrik, bëj betimin pastaj bëhem President. Tani jam anëtar i LSI-së dhe do të kontribuojë për LSI-në. Nuk do të dal të bëj pretime që do hapim vende pune, apo do të ulim taksat sepse kjo i takon Petrit Vasilit dhe ekipit drejtues të LSI-së. Por ama do të shkojë kudo në të gjithë Tiranën dhe të them që të votoni Klajda Gjoshën, votoni Kejdi Mehmetajn, votoni Ardit Çelën, votoni të gjithë këta të rinjtë e të rejat mrekullueshëm sepse këta janë ata që i duhen parlamentit të Shqipërisë. Njerëz të përgjegjshëm, të rinj të motivuar, me vizion, patriot, që i japin një shpresë të rinjve se ky vend do të bëhet që të mos ikin. Dhe jo vetëm të votojnë gjithë këto të rinj e të reja, sidomos tek lista e Tiranës, se kjo është tamam Republikë e Re. Po ta shikosh listën e Tiranës. Kështu që tani do të bëj thirrje për të gjitha partitë që kanë njerëz të rinj që t'i çojnë në Parlamenti, që të çojnë një kulturë të re atje dhe të mos zihen më duke thënë se ai ka qenë i dënuar, ai ka qenë në burg, por të shkojnë të flasin për të drejtat e rinisë, të flasin për problemet e arsimit, për problemet e familjes, për çështjet sociale në mënyrë që të zgjidhen këto probleme.

**Megjithatë në qoftë se më lejoni, pyetja ime është, duke qenë se tani do të jetë Petrit Vasili për të cilin unë kam respekt, nuk mendoj se LSI-ja nuk mund të dobësohet në këto zgjedhje?**

Aspak. Nuk është çështje fytyre, por është çështje filozofie dhe mbi të gjitha LSI-ja është në një rritje e cila është një rritje në progresion gjeometrik për shkak të risisë së jashtëzakonshme që ka në të gjithë Shqipërinë, të rolit që i jep rinisë, të përfshirjes që i jep asaj, të protagonizmit dhe padyshim që kjo është fuqia më e madhe e LSI-së, ky është edhe investimi më i madh që unë kam bërë në këto 14 vjet në LSI. Tani ata jo vetëm janë rritur por kanë krijuar edhe një personalitet shumë të fuqishëm por edhe ecin vetë dhe ecin të sigurt edhe të jesh i sigurt që do të bëjnë nj çudi të paparë në këto zgjedhje.

**Kështu ke thënë edhe në zgjedhjet e kaluara. Tani përveç entuziazmit euforisë…**

Nuk është eufori, është thjeshtë një realitet.

**Ju jeni dakord me mua se duke qenë se secila parti do të hyjë në zgjedhje, penalizohen partitë e tjera…**

Nuk penalizohet LSI-ja sepse është e njëjta për çdo parti tani. Nuk është se PS ka një koalicion me disa parti dhe LSI nuk ka. Janë të barabartë tani.

**Kur ishit në koalicion me PS në 2013 dhe morët 16 deputet, po të mos ishit në koalicion nuk do të kishit marrë 16…**

E keni shumë gabim sepse ai është një manipulim që bënë analist të caktuar. E vërteta është se LSI ka marrë 180 mijë vota dhe mori 16 deputet. Edhe sikur të ishte e vetme prapë të njëjtën gjë do të merrte. Në rastin konkret nuk është se kemi PS në një koalicion dhe LSI pa koalicion. PS është pa koalicion, LSI pa koalicion, PD pa koalicion pra është në kushte krejtësisht të barabarta.

**Ju pëlqen kjo gjë?**

Më pëlqen sepse gara është e bukur. Gara është demokraci dhe demokracia sjell surpriza.

**Dua të thuash të vërtetën që ju besoni?**

LSI e ka ndarë mendjen që të jetë forcë e parë në këto zgjedhje.

**Nëse del LSI forcë e parë, sigurisht një nga të tjerët duhet të bëj koalicion me ju nëse LSI i keni 71. Në qoftë se ju dilni forcë e tretë, do të bëni koalicion me partinë e parë apo me partinë e dytë sepse në Maqedoni shqiptarët shkuan me partinë e dytë…**

Ne funksionojmë me demokraci. Kush shkon 71 nuk ka rëndësi i pari, i dyti apo i treti. Kështu që kjo është punë e Petrit Vasilit.

**Pas datës 24 korrik ju nuk merreni më me LSI?**

Nuk është se nuk ka lidhje, por ky është një vendim që i takon formuese të LSI-së.

**Nëse do të ishit kryetar i LSI-së me kë do të bëje koalicion?**

Nuk mund të them dot gjë sepse në politikë nuk mund të paragjykohet. Do të shikohet situata se si do të ecë fushata, do të jetë normale, jo normale. Ajo që mund të them me bindje se LSI-ja do të bëj më të mirën për Shqipërinë. Këtë e them me bindje. Pastaj se si e vendos LSI-ja kjo do të varet nga rrethanat e saj. Më thuaj një rast që LSI-ja nuk ka bërë më të mirën për Shqipërinë. Gjithmonë ka vendosur me përgjegjshmëri, me shumë vullnet pozitiv dhe asnjëherë nuk është bërë pengesë për integrimin evropian, asnjëherë nuk ka cenuar stabilitetin e vendit, asnjëherë nuk ka qenë protagoniste për konflikte artificiale. Gjithmonë ka qenë për zgjidhje, për bashkëpunim, për qetësi, për dashur.

**Dhe kështu do të vazhdojë?**

Besoj se po sepse ndryshe nuk rritet.

**Pra duhet të jetë pozitive që të rritet?**

Patjetër! Interesi publik dhe pozitive. Shpresë, gjithëpërfshirje, respekt për njerëzit, fjala e mbajtur, mirënjohje.

**Atëherë nëse ke këtë filozofi, më vjen keq ta them por ta ka vjedhur Edi Rama. Sot më kurrë pasi ai u bashkua me Bashën…**

Shumë mirë, gëzohem. Rëndësi ka që të fitojë filozofia.

**Më vjen mirë që je i qetë dhe në kohë furtunash politike…**

Është detyra ime të jem i qetë dhe i çdo politikani.

**Nuk e ke si natyrë, e bën këtë me detyrim?**

Nuk kam qenë ndonjë natyrë kaq e qetë dikur, por tani edhe përvoja dhe eksperienca dhe ndërgjegjësimi për detyrën që duhet bërë.

**Në vitin 2008 ajo që bëri Rama me Berishën duke ndryshuar kodin zgjedhor ngjante si tragjedi, ajo që bëri Rama me Bashën ngjan di komedi..**

Unë e thashë se nuk përsëritet njësoj dy herë historia, një herë si tragjedi, një herë si komedi, pastaj ti ke dëshirë t'i vësh emra, kjo është puna jote.

**Ju jeni një parti e qetë e përgjegjshme dhe që merrni vendime herë pas here dhe publiku duhet ta presë këtë gjë nga ju. Si ka mundësi që pas këtyre ndryshimeve, pas heqjes se z. Petrit Vasili nga posti i Ministrit të Drejtësisë edhe pse ju i kishit dhënë të gjitha postet për arsyet që i thatë si ka mundësi që pas kësaj ju nuk patët jo inat, por për t'i hapur rrugë sa më shumë këtij koalicioni apo kësaj marrëveshje apo për të mirën e vendit LSI vazhdon të rrijë ende në qeveri?**

Po, sepse ne kemi një marrëveshje me PS.

**Ka mbaruar marrëveshja më 1 prill?**

Marrëveshja vazhdon deri në fund të mandatit të kësaj qeveria. Nuk është se LSI është e vendosur në një koalicion tjetër, i cili është përballë PS. Fundi i mandatit është 9 shtatori kur të krijohet parlamenti i ri.

Është tregues përgjegjshmërie, normaliteti.

**Kjo do të thotë se pas 25 qershorit nëse nuk do të ketë nevojë për votat e LSI ju do të vazhdoni të rrini në qeveri edhe pse do të jeni opozitë?**

Nuk e besoj se kjo është përgjigja, por kjo është një përgjigje që i takon z. Vasili nuk më takon më mua të them se çfarë ndodh pas 25 qershorit. Unë si anëtar i LSI-së deri më 25 qershor do të bëj çdo gjë për të përkrahur LSI-në që të dalë forcë e parë dhe sidomos kandidatët dhe kanditatet e reja të LSI dhe sidomos gratë që kandidojnë nën siglën e LSI-së.

**Fushata që do të bëjë LSI tani do të jetë pozitive pa asnjë fjalë kundër PS-së, lidershipit të PS-së apo PD-se?**

Gjithmonë pozitive ka qenë. Pse duhen thënë fjalë të këqija duhen thënë vetëm fjalë të mira.

Slogani i LSI-së është një shans për të gjithë. Kjo është një sigël shumë e fortë, apo të ecim përpara, koha për veprim. LSI është partia e shanseve e gjithëpërfshirjes.

**Rama ka "Shqipëria që duam". Po z. Basha? Sepse ju jeni në aleancë dhe shqiptarët janë disi konfuzë?**

Shqiptarët janë të qetë, sepse do të ketë zgjedhje me opozitën dhe kjo është kryesorja.

**Po çfarë ndodhi ?**

Ndodhi që u rivendos besimi dhe do të ketë zgjedhje gjithëpërfshirëse dhe kjo është pozitive.

**Ishte rastësi apo ishte koincidencë që kjo marrëveshje u bë më datën 17 maj duke u gdhirë 18 maj që është edhe dita ndërkombëtare e LGBT-së?**

Nuk e di nëse kjo është një e vërtetë apo një koincidencë, por kjo më duket gjëja më e parëndësishme.

**Nuk mendohej kurrë që z. Rama do të bëhej një Romeo dhe do t'i luteshe z. Basha..**

Po ja që edhe duke u lutur arrin diçka. Më mirë të lutesh sesa të refuzosh. Gjithpërfshirje jo përjashtim.

**Pse nuk e tregon që je pak I mërzitur nga situate?**

Unë nuk jam i mërzitur nga situate. Unë jam jo shumë i kënaqur sepse kjo situatë as nuk duhet të ekzistonte në Shqipëri.

**Por sot duhet të ishe i lumtur që ka marrëveshje?**

Më duket se jam i qetë.

**Jo nuk të njoh mirë? Ke diçka në mendje?**

Absolutisht, mendoj se është gjë pozitive që të ecim drejt 25 qershorit me besimin që do të kemi zgjedhje të gjithë pranuara edhe që kemi evituar, kemi lënë pas një skenar të paparashikueshëm për vendin.

**Pse çfarë do të thotë të paparashikueshëm për vendin. Për çfarë të shkon në mendje Ilir ?**

Na ka ndodhur ndonjëherë që mos të hyj opozita në zgjedhje. Na ka ndodhur që një palë të thotë do bëjmë zgjedhje pa opozitën dhe opozita të thotë që nuk do të ketë zgjedhje atë ditë. Nuk na ka ndodhur. Çfarë do të bënim do të nxirrnim njerëzit kundër njerëzve.

**Kam mesazhe dhe me thonë Kaubojsi është pjesë e koalicionit, meqë u bashkua me Lulin…**

Nuk kam përgjigje për këtë çështje.

**Si t'u duk kur patë Bashën dhe Ramën që shtrëngonin duart në fund të atij takimi?**

Kjo më duket siç më ndodhi mua me Doktorin. Se dhe unë pa e takuar Doktorin nga afër kisha shumë ngarkesa edhe isha gati për luftë. Por që kur e takova pastaj ndryshova dhe pashë dikë tjetër.

**Pra, kur e njeh kundërshtarin nga afër është më ndryshe?**

Po, ndikon. Dhe kjo është gjë e mirë, sepse nga larg e paragjykon sepse kur njihesh nga afër është më mirë.

**Pra, e kupton që kur e njeh nga afër, ai që ke parë nga larg nuk është gjë tjetër, veçse një aktor?**

Për shembull, vjehrra ime kur bëmë koalicion me PD, se ishte e majtë dhe e kishte tmerr Doktorin, por kur i fliste Doktori thoshte nuk qenka i keq ky, qenka i mirë.

**Këta ishin takuar edhe më përpara?**

U takuan për të zgjidhur një situatë. Nuk u takuan për të mbajtur disa qëndrime ndarëse dhe të papajtueshme.

**Këtë herë janë takuar vetëm tre orë?**

E rëndësishme është që kemi një produkt pozitiv.

**Po si shpjegohet që ky takim historik ndodh në ambientet e Kuvendit? Bë zyrat e tua…**

Ato nuk janë ambientet e mia, janë të Kuvendit. Kuvendi është edhe i mazhorancës edhe i opozitës. Ata kanë qenë në shtëpinë e tyre.

**Pse e ndërruan sallën?**

Nuk e di këtë gjë. Ç'rëndësi ka se e ndërruan?

**Kishte kamera në sallën ku filloi takimi.?**

Ju donit patjetër të filmohej takimi. Të regjistrohej? Rëndësi ka produkti. Produkti është pozitiv.

**Na intereson procesi, jo produkti.**

Ju duhet një proces me opozitën, apo pa opozitën. Një proces i qetë dhe i sigurt, apo konfliktual?

**Procesi, jo rezultati. Rezultati në fund është i trishtuar, si të jetë i mirë, si jo. Miti i Sizifit, kënaqësia është kur ti e ngre gurin e madh deri në majë, momentin që ai shkon në majë një moment të caktuar ai bie prapë, dhe kënaqësia dhe lodhja është kur ti e ringre, kur tejkalon veten.**

**(VIJON NË FAQEN 16)**

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.


# Dilni shihni nëpër Shkodër…

**- Reportazh-**

**Për ty që nuk e ke vizituar prej vitesh Shkodrën, duhet të vihesh në kërkim të imagjinatës, në kërkim të rikthimit të kujtesës, që të ngjan se të ka tretur larg, fort larg, në tis të mjegullt vegimesh. Ai qyteti bukurosh, sy blu, me rrugicat karakteristike e bahçet plot frute e aromë, me shtëpitë e bukura, ku vajzat qëndisin nëpër shameshine, duke drejtuar "antenën" përtej avullisë, mos dëgjojnë ndonjë serenatë, tashmë është rritur e stolisur, pa humbur asgjë nga nuri e ndjesia e kahershme. Rrugët e gjëra janë ato, blirët shekullorë janë aty, pemët e lulet në çdo rrugë e oborr, barcaletat e hajgaret në çdo mejhanë…**

**Parkon pak vemëndjen në "kërthizë" të qytetit, bash njaty ku Kisha Françeskane e Gjuhadolit dhe Xhamia e Fushë-Çelës (sot Ebu Bekër) me rastin e 1 vjetorit të Pavarësisë, më 28 nëntor 1913, "shkruan" një event, unik në botë. Këmbanorja i pat lëshuar mbi "qafë" krahun e djathtë Minaresë e e Minareja të majtin Këmbanores, ku mbi atë bashkim "trupash" dritat me rreshtin e gjatë të kandilave kuqezi, bashkuan me ndriçim nëpër flamuj, dy besimet, për të mos u ndarë kurrmë.**

**Ky sokak e kjo histori, bukur boll, janë plotësuar me nota identiteti. Aty pari, simethënë në mes, grupe vizitorësh të huaj, pëditë e përnatë, shkrepin blicet e aparateve para Shtatores së Shenjëtores Nanë Tereza, nënës më të famshme e më humane që njeh Bota deri sot. Nja tetë kilometer prej këtu, bash në Shirokë, gjejnë shtëpinë ku ka jetuar disa kohë kjo Shenjëtore…**

**Mbi identitetin bazë," damarët" e Shkodrës, me rrugë të gjëra e të pastra, me infrastrukturë të moçme, klasike e moderne, i ngjajnë një trupi të shëndetshëm, të shkrirë një me njeriun, me nevojat e tij.**

**Plot e përplot butësi e elegancë, si një format krijimtarie dhe ëndërr ideali të njeriut, e sheh gjithkush këtë infrastrukturë ku janë shtrirë rrugët, ku rrethrrotullimet e shumta e lulishtet, janë kudo nëpër udhët e gjëra të qytetit që lëshon shtat përditë.**

**Në Shkodër nuk janë hedhur shumë lopata me beton, por plot dashuri, vëmëndje, larg laroshive klanore me ndërtime që sjellin fitime të përkohshme e plakin qytetin.**

**Mes ndjenjës së mrekullisë e magjisë, mes befasisë e bukurive si këtu, gjen mjaft intelektualë ku diskuton me ta, jo si në ndonjë qytet tjeter për gropa e baltë, por për gjithçka lidhet me identitetin e kulturën e këtij qyteti. Që nga Tempulli i Rozafës, meshari i Gjon Buzukut, Marin Barleti, Pashallaku i Shkodrës, Karl Gega, Kel e Pjeter Marubi, Lahuta e Fishtës, nga poezitë e Ernest Koliqit, Arshi Pipës, Martin Camajt, Frederik Reshpes, e deri tek këngët e Bik Ndojës e Shyqyri Alushit apo vokali i ish tenorit ndër më të famshmit në Europë Lukë Kaçaj, mund të debatosh, edhe para një tave me krap Liqeni, Bune a Drini, që gatuhet më mirë se gjithkund.**

**Është një qytet plot e përplot histori, legjenda e mite, plot e përplot barcaleta, këngë e lule. Shumë sheshe janë me kalldrëm të gjërë, duke ruajtur strukturën, veçmas atë austriake, ku më 1914 pat marrë format europian, ndërthurur me traditën e një bahçeje me lule, ku porta e Shkodrës, e hapur në jetë të jetëve për miqte dhe e mbyllur për pushtuesit, Bahçalleku, ka emër bahçeje, emër të një lëndine lulesh.**

**Kalaja me moshë rreth 30 vjet më të re se Nusja Shkodrane Rozafë, Nëna Shkodrane Rozafë që u muros këtu për të mbajtur muri që ditën ndërtohej e natën rrëzohej, e u flijua për tu ndërtuar Shkodra mbi shtatin e saj, i takon të jetë nja 400 vjet më e lashtë se Jezu Krishti.**

**Qyteti i Shkodrës tashmë është krejtësisht i ndriçuar.** Shumë rrugë **janë vërtetë të magjishme, janë pedonale. Ja rruga nga Parruca e deri tek Univesrsiteti "Luigj Gurakuqi", ku jo shumë larg në kohë në mes të saj bënte demonstrim force monumenti i Stalinit, kjo tjetra tek Ura e Bunës, kjo nga Rrapi 400 Vjeçar afer "Radio Shkodrës" e deri tek Tregu i Zdralajve, apo nga ish Dugajt e Reja në Gjuhadol, ka vite që nuk pranojnë makina.**



**E parkuam pëndën në pedonalen para "Kafesë së Madhe" edhe tek diktatori Stalin, për të hequr paralele mes persekutimit komunist në Shkodër e atij në Rusi.**

**Vitet e hetuesisë, burgut dhe vuejtjes së klerit katolik në kampet e shfarosjes komuniste, janë fiks 881. 66 janë pushkatuar dhe vdekur në burgje. 65 të tjerë janë arrestuar dhe vuajtur dënime të tmerrshme. Këta martirë, relika të çmuara të Shkodrës tashmë, kanë kryer studimet e larta në 24 Universitete të Evropës me 450 vjet studime. Dekreti Papal i Vatikanit për shpalljen zyrtarisht të martizizimit të 38 Martirëve të Kishës Katolike, të vrarë në vitet 1945-1074 nga regjimi komunist, është një "gjerdan" për Shkodrën, vlerë për Shqipërinë.**

**Një tragjedi e pashoqe është edhe në klerin musliman, ortodoks e bektashinj, që vunë jetë në analet e historisë, për t'i dhënë jetë e nder këtij qyteti që shkëlqen.**

**E megjithëkëtë, sytë e Shkodrës sot nuk janë të përlyer me mllef, urrejtje. Është hedhur pas krahëve e shkuara. Njerëzit, jeta dhe ambienti kanë lidhje harmonike. Ngjyra gri në të bardhë që dominon sot nëpër shëtitore, ose Piac siç e quajnë prej qindra vitesh vëndalinjtë, është ngjyrë pastërtie, paqeje, ngjyrë velloje nuseje, saqë kur e shikon me sytë e mëndjes, ndoshta edhe duke kërkuar diku aty, ndonjë kujtim të fshehur të rinisë, mëndon:**

**Aty tek hoteli Katër Yjësh ishte byrektorja ku… dikur qerasje me një byrek një shok a shoqe, tek Rektorari i Universitetit "Luigj Gurakuqi" ishte Komiteti i Partisë së Punës, ku rrinin hijerëndë në Olimp burrokratët që prisnin koka njerëzish për një fjalë goje a barcaletë. tek ky gjimnazi këtu ishte burgu Politik i Shkodrës, ku u pushkatuan qindra heronj të lirisë e demokracisë, ndër ta edhe Prekë Cali që njihet si personi që insistoi në vëndosjen e kufirit mes Shqipërisë e ish Jugosllavisë dhe arriti që zonën e Kelmendit ta lërë tokë shqiptare…**

**Sheshi mes Kishës së Fretërve, Xhamisë "Ebu Bakër" e Hotel "Rozafës" shëndërrohet disa herë në muaj në skenë arti, ku qyteti mbushet plot e përplot njerëz që ndjekin të gëzuar këngë, valle, humor, instrumentistë.**

**Shumë piktorë punojnë aty mbrëmjeve të qeta, mbi telajo, shumë të rinjë … gjuajnë me "guralec"…, me një zile të lehtë telefoni njëri-tjetrin, duke shkruar kështu njohjet e para në këtë sokak që ngjan edhe me këngë dashurie, edhe me ujvarë, edhe me dritë, edhe me "dehje" shpirti.**

**Në panairet e shpeshta bëjnë shenj punimet e artizanevë shkodranë, ku prek me dorë shpirtin e tyre krijues. Është ky një profesion i trashëguar prej mijëra vitesh, njëlloj si mikpritja, pastërtia, besa e burrëria…**

**Qyteti ka funksion tregtar e strukturë të veçantë për zhvillimin e një karakteristike funksionale, në shërbim të njeriut, të jetës së njeriut, në shërbim të natyrës, të jetës së natyrës, ndaj u thërrasim: Dilni shihni nëpër Shodër…**

**Sokol Pepushaj**

# The electoral campaign in the North is strained

The electoral campaign has entered a fierce stage with tensions and violence. The Socialist Party, not only is using criminal elements and drug's money, but also gangs for pressure on political opponents. The Socialist Party, on June 25th, after the exit from the tent of the opposition, seems to have decided to buy the votes at any price to vandalize the power of crime and corruption.

In the north, where Interior Minister Saimir Tahiri has released also criminals from prison to use them in the campaign, the situation is too severe. Opposition leader Lulzim Basha has denounced several cases where opposition is threatened. One of the many cases is the threat of the activist, the member of the election commissions of the PD in 20 years and a member of the Democratic Party, Pjerin Kaçi, in the city of Shkodra. Elements related to the crime of power have warned him to break away from the campaign and do not accompany the Democratic leader Lulzim Basha in meetings and activities. Kaçi has been known in the North for 20 years as a Democratic Party activist and as a descendant of a family persecuted by the communist regime of Enver Hoxha.

Important PS persons are hiding behind pressures and people who distribute money by buying voters, even on sunny days, and where the police do not only intervene, but also helps them. The very serious event recorded two days ago in the "Three Heroes" neighborhood of Shkodra, where unknown persons have robbed and physically harassed the minor Kleidio Pjerin Kaçi, is the most shameful act of the worst prime minister in history of our country. Prime Minister Edi Rama, a descendant of dictatorship, as he calls the opposition in all electoral meetings, has dropped out of the drug and is buying voters these days. The minor Kleidio Kaçi, around 18.00 on 22.05.2017, was robbed by unknown masked persons in the street and after having been physically violated, they left him unconscious, and took him and have thrown him near the house. This is what appears to be the latest pressure and warning for the father of this teenager, Pjerin Kaçi, who means that state criminals kill also children just to keep their power.

This situation of violence has intimidated the simple democrats, who are under the terror, are forced not to participate massively in the electoral meetings of the Albanian opposition.

**The Editorial Office**

# Komunikimi javor: Rama: Pakt me PD për fundin e krizave, dialog për integrimin pas zgjedhjeve

Kryeministri Edi Rama në komunikimin javor të tij sqaroi disa nga dilemat mediatike që pas marrëveshjes së arritur midis tij dhe kreut të opozitës Lulzim Basha.

Duke theksuar se marrëveshje nuk është një koalicion kundër partive të vogla, Rama deklaroi se me kryetarin e opozitës pas 25 qershorit takimet do të jenë të vazhdueshme për hapat integruese të vendit.

Sipas tij, kjo marrëveshje i jep fund krizave politike 27 vjeçare dhe se ministrat teknikë të opozitës do të jenë kujdestar për zgjedhjet. Sipas tij, marrëveshja e bën Shqipërinë shtet serioz në botë.

Rama bëri me dije gjithashtu se kishte rënë dakord me Bashën për të mos prekur Kodin Zgjedhor me ca arna, por të bëhej një reformë e thellë pas zgjedhjeve.

**Rama**: Kjo javë solli atë mbase vetëm unë e besoja në këtë qytet se ende mund të ndodhte; ngritjen e çadrës së frikës nga drejtësia dhe hapjen e bulevardit për Vettingun dhe pjesëmarrjen në zgjedhje të të gjithëve.

Si e qysh u arrit kjo marrëveshja është një libër më vete, kapitujt e të cilës janë ca më ndryshe nga çfarë është lexuar gjatë gjithë kohës të lajmeve dhe analizave të bëra në megjelisin mediatik.

Debati në katundin politik dhe mediatik është fokusuar thjesht tek ndryshimet në qeveri dhe fakti që nuk është rihapur rruga e krijimit të koalicioneve.

Ata që rendën t'i quajnë ndryshimet në qeveri pazare për tendera, koncesione dhe konfeksione janë po ata që klubet e katundit të politikës dhe medias i frekuentojnë për të kapur kocka.

**Minstrat teknikë** – Fakti është se edhe pa u bërë marrëveshja, qeveria me një urdhër administrativ të nxjerrë prej meje më datë 12 maj, ishte angazhuar të mos shpenzonte më asnjë para publike të paparashikuar dhe të mos bënte asnjë procedurë të re.

Ministrat e rinj teknikë të votuar me konsensus dhe të propozuar nga opozita do të jenë në detyrë si kujdestar të etikës zgjedhore që do të garantojnë mos përdorimin e administratës në zgjedhje dhe ndalimin e çdo forme presioni ndaj punonjësit e shtetit për të tu marrë votën.

E njëjta gjë edhe për drejtorët e agjencive të mëdha. Ky është në thelb dallimi i qeverisë teknike për të zbatuar një program politik dhe ministrave teknikë që përfshihen në një afat konkret me një qeveri politike për të kufizuar përdorimin e mjeteve në dispozicion të qeverisë dhe për të ndaluar ndikimin e shtetit gjatë një periudhe zgjedhore.

**Fund kontestimit të zgjedhjeve-** Kjo është premisë e shkëlqyer për t'i dhënë fund një historie pa mbarim zgjedhjesh që kontestohen nga pala që del e humbur.

Më 25 qershor të kemi zgjedhje të lehtësuara si kurrë ndonjëherë nga pesha e makinerisë shtetërore dhe në përfundim të tyre askush nuk mund të fillojë avazin e vjetër të kontestimit tradicional të rezultatit duke u ankuar për rolin e shtetit.

**Marrëveshja shkon përtej zgjedhjeve-** Marrëveshja shkon përtej këtij fakti. Angazhimi i palëve përmban angazhimin për zgjedhjet si pjesë të angazhimit të mëtejshëm të mazhorancës dhe opozitës së dalë pas zgjedhjeve të 25 qershorit për të qenë së bashku në rrugën e çeljes së negociatave për anëtarësim në BE. E thënë ndryshe, mos dakordësinë mes të dyja palëve në rrugën e bashkëjetesës demokratike nuk do të jenë më arsye për t'u bërë gazi i botës në sytë e Evropës ku për 27 vite jemi bërë sikur të ishim armiq me kombësi të ndryshme, si të ardhur nga shtete të ndryshme.

**Institucionalizimi i dialogut pozitë-opozitë** –Marrëveshja përcakton detyrimin e ndërsjellë të palëve si vullnet për të institucionalizuar dialogun pozitë-opozitë pa pritur më miqtë e huaj që të bëjnë shkesin për të na ulur në tryezë.

Tryeza e dialogut do të jetë e hapur jo vetëm kur gjërat shkojnë në zgrip. Periodikisht, kryetari i qeverisë dhe kryetari i opozitës do të takohen për të diskutuar për ecurinë e integrimin, për çështje te interesit kombëtar që duhen adresuar nga politika jonë e jashtme, për mirëkordinimin me faktorin politik shqiptar në rajon si dhe për punën e përbashkët që të përfshijë diasporën në jetën politike të vendit.

Zbatimi i saj na bën më në fund një shtet serioz në sytë e botës, por më shumë se kaq në mbrojtje të interesave të mëdha të vendit.

**Paketa McAllister recetë** -Paketa e famshme e McAllister ishte një recetë për të na ndihmuar, ndërsa marrëveshja e arritur është një platformë për tu përpjekur së bashkuar për të zgjidhur zinxhirin 27 vjeçare të krizave që shpikin partitë dhe i paguanin vendi.

**Goditje partive të vogla? –Rama**: E godasin këtë marrëveshje si një pazar të madh bashkëqeverisje mes PS-së dhe PD-së në kurriz të demokracisë, apo në kurriz të partive të vogla, të cilat ne gjithë respektin nuk mund të jenë garant të demokracisë dhe të drejtësisë as nuk kanë qenë as nuk mund të jenë dot jo vetëm në Shqipëri po askund.

**Bashkëqeverisja deri në zgjedhje** – Ka vetëm një bashkëqeverisje në këtë marrëveshje, bashkëqeverisja e zgjedhjeve për të siguruar një Fair-play. Këtë herë jo vetëm administrata zgjedhore është e baraspeshuar, por edhe vetë qeveria është e bashkëvendosur bashkërisht vetëm këtë funksion.

PS dhe PD kanë qenë kundërshtare, janë dhe do të jenë kundërshtare politike. Dy alternativa pushteti me programe krejt të ndryshme. Mbi të gjitha dy rrugë krejt të ndryshme.

**Na duhen 71 mandate:** Me këtë marrëveshje, PS ka treguar edhe njëherë se është fuqia e vetme e këtij vendi. Na duhen të paktën 71 mandate duke e mbajtur ne timonin e reformave shtetbërëse në rrugën e re që kemi nisur.



U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



# Demo-Christians, victims of political and Islamic terror

Data collected from the Population Census on Nationality and Religion 2011, show that 57.12% are declared Muslims, 10.11% Catholics, and 6.8% Orthodox. Atheists are declared 2.52%, Bektashis 2.11%, while evangelists 0.11%. This by asking many Albanians who live abroad and who happened to be in 2011 in Albania. So, the Catholic part that currently lives in Albania is much smaller, as it is much higher the Muslim part. We are today a unique place in Europe that mosque's high speakers are burning with high volume five times a day. We are the most troublesome place for volunteering in Syria to the ISIS terrorist organization. Thus, Catholics, especially Christian Democrats, have been victims of political and Islamic terror since the state has captured criminal and terrorist groups. The killing with TNT explosion of the Demo Christian Party Chairman of Malesia e Madhe, Aleksander Keka, on June 18, 2009, ten days before the parliamentary elections of June 28, 2009, was named by Nard Ndoka's Demo Christian Party chairman: "political assassination and terrorist attack. Keka was constantly threatened by terrorist from politics and Islamic terror hiding behind politics."



Even the well-known Albanian Christian Democrat Mark Gurraj is one of the innocent victims, but was designed to be killed. Since that black year when Aleksander Keka was killed, he joined the Christian Democratic Party. It was March 2009 when the branch of this party was established in Milan, Italy, and Mark Gurraj became a member and worked hard for the socio-economic and moral policies of Christian philosophy. Demo Christian Gurraj has provided financial assistance and the Branch of the Albanian Demo Christian Party in Milan has accumulated funds for the PDKSH in Albania, especially for the parliamentary elections of June 23, 2013 and the elections for the local government of June 21, 2015. The amount of funds from Albanian emigrants from Italy to PDKSH – exceeds of 150,000 euros. This was where the terrorists draw attention the Christian Democrat Mark Gurraj, who as it looks became troublesome during the organization of two buses with about 80 immigrants, who came to vote in Albania on June 21, 2015, and he seemed to be concerned about the politics of terror and the terror of the politics.

He has been threatened several times by strangers telling him that he was becoming troublesome for the politics and power in Albania. Mark Gurraj has also been a member of the Albanian Immigrant Association in Rome, where he has raised his voice in defense of the rights of Albanian emigrants in Italy against racism, discrimination and persecution by neo-fascist extremists of the Neo-Fascist Party of Gianfranco Fini and Umberto Bossi's Lega Nord. Even Italian carabinieri has treated him badly because of Albanian nationality. This is probably because Albania is the main country supplying Italy with drugs, where it has been possible to seize up to 12 tons of cargo only in an undiscovered action. So, the mafia and terror attack the honest people and especially activists for freedom and human rights. The activity of Christian Democrat Mark Gurraj has been public in meetings, rallies, posters, and financial aid for the Albanian Democratic Christian Party, until about a year ago, when he was forced to leave Europe to secure his threatened life. His parents have also supported the Christian Democratic Party since its creation in the distant year of 1991.

**The Editorial Office**

# Historia e shteteve te bashkuara të Amerikës




Banorët e parë të njohur në territorin e sotëm të Shteteve të Bashkuara besohet të kenë ardhur aty gjatë një periudhe prej disa mijëra vitesh, e cila filloi diku rreth 15,000 - 50,000 vjet më parë, duke e kapërcyer Beringinë për në Alaskë. Prova të qarta të vendosjes së këtyre kulturave në territorin që më vonë do të bëhej ShBA datojnë prej 14,000 vite më parë.

Hulumtimet kanë zbuluar shumë për banorët e parë vendasë në Amerikën veriore siç shpjegohet nga Cyrus Thomas. Njerëzit e Kolombosit bënë zbarkimin e parë të dokumentuar të botë-vjetërsve në territorin e sotëm të Shteteve të Bashkuara kur arritën në Portoriko gjatë udhëtimit të tyre të dytë më 1493. Juan Ponce de León, i cili arriti në Florida më 1513, konsiderohet Evropiani i parë që shkeli pjesën kontinentale të Shteteve të Bashkuara, megjithëse sipas disa provave, John Cabot mund të ketë arritur Anglinë e re më 1498.

Në fillimet e tyre, Shtetet e Bashkuara përbëheshin nga trembëdhjetë koloni, që ishin shtetet e sotme që okupojnë po të njëjtin territor që kishin edhe kur ishin koloni Britanike. Kolonistët amerikanë i mposhtën Britanikët në Luftën Revolucionare Amerikane të viteve të 1770-ta dhe shpallën pavarësinë më 1776. Shtatë vite më vonë, nënshkrimi i Traktatit të Parisit zyrtarisht ia njohu pavarësinë nga Britania e madhe.[8] Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, zgjerimi i territorit amerikan drejt perëndimit filloi, mbi besimin në Fatin e Manifestit, sipas të cilit Shtetet e Bashkuara do të okuponin të gjithë tokën e amerikës veriore nga lindja në perëndim, nga Oqeani Atlantik e deri tek ai paqësor. Më 1912, me hyrjen e Arizonës në Union, Shtetet e Bashkuara ia arritën qëllimit. Shtetet e Alaskës dhe Hawaiit u paranuan të dyja më 1959.

E ratifikuar më 1788, Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara shërben si ligj suprem amerikan në organizimin e qeverisë; Gjykatës supreme është përgjegjëse për ligjin Kushtetues. Ka pasur mjaft përparim social prej shekullit të 19-të; këto zhvillime janë reflektuar gjerësisht në Kushtetutë. Skllavëria u ndalua më 1865 nga Amandamenti i Trembëdhjetë i Kushtetutës Amerikane; Amandamenti i Katërmbëdhjetë dhe Pesëmbëdhjetë që e pasuan atë garantonin shtetësi për të gjithë personat e natyralizuar brenda territorit të Shteteve të Bashkuara dhe të drejtë vote për personat e të gjatha racave. Në vitet e mëvonshme, të drejtat civile u zgjeruan për gratë dhe amerikanët me ngjyrë, pas lobimit të aktivistëve socialë. Amandamenti i Nëntëmbëdhjetë i Kushtetutës Amerikane ndaloi diskriminimin gjinor në të drejtëne votës; më vonë, Akti i të Drejtave të Njeriut i 1964 dënonte si krim ndarjen ose veçimin e personave sipas racave në vende publike.

Epoka Përparimtare shënoi një kohë të zhvillimit ekonomik të Shteteve të Bashkuara, duke u zhvilluar në Të njëzetat hungëruese (Roaring Twenties). Sidoqoftë, Rënia e Wall Street më 1929 çoi tek Depresioni i madh, një kohë e rënies ekonomike dhe papunësisë së lartë. Rrjedhimisht, qeveria amerikane themeloi "New Deal" (Marrëveshjen e re), një seri e reformave dhe programeve që kishin për qëllim të asistonin ata që prekeshin nga Depresioni. "New Deal" kishte sukses të ndryshueshëm. Siqodoftë, kur Shtetet e Bashkuara hynë në Luftën e dytë botërore në Dhjetor 1941, ekonomia shpejt u rimëkëmb, madje aq sa ShBA-të u bënë superfuqi botërore në agim të Luftës së Ftohtë. Gjatë Luftës së ftohtë, SHBA-të dhe Bashkimi Sovjetik ishin dy superfuqitë e botës, por me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe rënien e Bashkimit Sovjetik, Shtetet e Bashkuara mbetën superfuqia e vetme në botë.

# *The government releases criminals from jail to use them during the electoral campaign*

After about a month, parliamentary elections are held. With the direct intervention of Prime Minister Edi Rama, according to the opposition chief Lulzim Basha, many dangerous prisoner criminals have been released from prison to use them in the electoral campaign to steal the June 25th vote. Lul Berisha a criminal person in Durres and Emiljano Shullazi have been released and Klement Balili– a wanted internationally criminal has not been arrested for months. All these three dangerous criminals have been mentioned by name from the US ambassador in Tirana, Donald Lu. The ambassador's strong statement has not triggered the state of crime that is endangering the lives of police officers as criminals are also retaliated against those who have handcuffed them.

Recently, the very dangerous criminal Gjovalin Kola in the prefecture of Shkoder was also released from prison. Shkodra has always been a hot crime scene. Gjovalin Kola was arrested on 21.11.2012 and was sentenced to 25 years in prison. So, according to the Court's final decision, it was time to finish the sentence after 20 years. This person was punished as a drug smuggler, for prostitution and murder, and he was sentenced to 25 years in prison, but now he is released after 5 years! This happens in Albania only. And this criminal has three other brothers who retaliate asks to kill regional police officers in the intelligence and arrest operation.

Gjovalin Kola and his brothers are known for many criminal acts in the Shkodra region. They are known as drug traffickers, prostitution and human trafficking organization.

Even the family members of these police officers feel jammed, as bands have support from politics. All of these and many others are being used by the mafia - government to steal the votes of 25 June.

An officer of the State Police, Sokol Gasper Gobeti, on March 13, 2017 survived an assassination attempt from drug and prostitution bosses, where his car with license plates SH 7692 C was exposed to explosives, TNT.

**The Editorial Office**

# Albanian Diaspora Continues to Support the Democratic Party. Socialists Reacting







Images from various political activities from the USA, especially fundraising events, , have been making news here at home and the Democratic Party is the beneficiary so far, and the Socialist Party is concerned.

It is a known fact that most the Albanian- Diaspora in the USA is predominantly Catholic or Christian and that fact that Lulzim Basha, the potential future Prime Minister of Albania, insulted them by stating that “The Socialist Party is recruiting Albanian Catholics of northern, most of whom criminals, to steal the election” has not weaken the Diaspora’s relation with their traditional party, the Democratic Party. Mr. Basha has since apologized to the Catholic community, and they appear to have forgiven him, especially the ones living in the USA.

“We had over 200 people at the last weeks event, which is one of the many we have held so far”, said Endrit Xhikneli, the organizer of this event in Hartford, Connecticut, where they spoke about the future of the party and the support the Diaspora can provide to it. “Over $25K was raised that night alone” said Mr. Xhikneli, who spoke with us telephonically. Further, these Albanian-Americans appear to be willing to come to Albania to camping and vote for their party.

“We are organizing the Albanian-American community in New York, Connecticut, Michigan and other places to get them involved in this year’s election in Albania” said Ilir Kola, whose family is closely related to Basha.

“We are honored by our family members in the USA, and are indebted to them. We appreciate the work they are doing and are confident that every dollar that they are raising for us will be spent for the purpose of defeating Edi Rama and his party” said Basha, who confirmed that he had meet with the Albanians in US a number of times in the past, where they had discussed the importance of the Diaspora’s involvement in this year’s election.

“I was interrogated last night by Albanian Security Agents about my political work and my son’s political involvement in US. And I know others who had the same problem” said Ermir Xhinkeli, the father of Endrit Xhinkeli. “They knew everything about my sons and their friends’ in USA. It really frightened me that they knew so much about them” continued Mr. Xhinkeli.

“Diaspora, especially Catholic from norther Albania, had mostly been disenchanted with Sali Berisha since 2005, but it looks like they are forgiving the party at this time” sated Sander Lelcaj, a political operative in the Shkoder District. “We have heard of case where Authorities are intimidating members of the family members of those Albanian living in the USA, trying to convince them to have their relatives in the USA stop supporting the democrats both financially and politically” said A. Hoti, an activist with the Malesi e Madhe branch.

“No Catholic, be it in US or Albania, should vote for Basha or his party” said Anxhelo Briska, a political advisor for the Socialist Party. “He insulted them and their religion. He called them criminals and in 2005, Topalli called them terrorists. How can they still support this party?” continued Mr. Briska

Can this year’s election really be decided by our Diaspora? It remains to be seen, but both parties are seeking their support.

**The Editorial Office**

U bëjmë me dije lexuesve tanë, që versioni online i gazetës është më i pasur dhe më i updatuar. Për këtë arsye, mund të qëllojë që ky version të jetë i ndryshëm nga gazeta që tregtohet në butik. E pavarur, regjistruar në Gjykatën e Tiranës, vendim nr.609/1; adresa: Tiranë, Rruga e Dibrës, tek Selvia. Kontakte: e-mail: shqiperia_etnike@yahoo.com; mob: +355 69 216 7955.



(VIJON NGA FAQJA 11)

**Jam i bindur që edhe ju vetë në jetën politike procesi ju mban?**

Juve ju pëlqen vuajtja, jo fitorja.

**Jo vuajtja, pasioni që bëni një rrugëtim.**

Jam shumë dakord.

**Pikërisht ndaj unë interesohem për procesin. Si ka mundësi që ai takim që zgjati tre orë, në një moment të caktuar në minutën e 45, Edi Rama kërkon të ngrihet që andej e të shkoni në një zyrë tjetër. Prisni pra! Atje te ajo zyrë që filloi takimi kishte kamera?**

Nuk e di. Kam qenë në Korçë atë ditë.

**Ju i njihni ambientet?**

Mua më intereson produkti. Produkti është pozitiv.

**Ç'mund të kenë thënë tre orë?**

Tre orë nuk janë shumë po të keni parasysh që te çadra ishin prej 4 muajsh. 4 muaj çadër aty, 3 orë për të zgjidhur këtë problem nuk është edhe shumë me thënë të drejtën.

**Po takimi juaj me Berishën, sa ka zgjatur më i gjati "tete-a-tete"?**

Kam qenë shumë herë. Nuk e di. Nuk e mbaj mend.

**Ka zgjatur tre orë për shembull?**

Duke pasur takime më të gjalla, doktori është gjithmonë më interesant.

Me dëshmitar, pa dëshmitar kjo është shumë e lodhshme. Ç'më duhen dëshmitarët mua dhe doktorit? Ne e mbajmë fjalën. Nuk kemi nevojë për dëshmitarë.

**E mbani mend kur dolët nga doktori ç'u thatë mediave? Që jeni të lumtur që kjo ndodhte, vetëm të bëhej publike.**

S'ishte bërë publike.

**Edhe ju vetë ishit kurioz?**

Unë kisha vetëm një shqetësim, Shqipëria të shkonte në zgjedhje me opozitën. Kaq. Ky ishte shqetësimi im. Asnjë shqetësim tjetër. Kam thënë të bëhet publike, normale. Ka shumë pika marrëveshja që është bërë, që do të zbatohen.

**Jeni dakord me të gjitha pikat?**

Nuk i kam lexuar të gjitha pikat. Për mua ka rendësi që opozita hyn në zgjedhje. Kjo është pika kryesore. Të tjerat janë të rëndësishme aq sa janë. Kjo është shumë e rëndësishme, që ne jemi një vend demokratik. Nuk është pak. E mbani mend? Edhe Ramiz Alia i shtyu zgjedhjet në 91-shin, që të hynte PD në zgjedhje që sa ishte krijuar. Apo s'e mbani mend?

**Pas paktit me Bashën ke komunikuar me mesazhe me Ramën? Çfarë thotë?**

Mirë, shumë mire. Më i qetë është, më i relaksuar.

**Do ketë mundësi që të jetë i qetë në qeverisje. Besoj edhe pas 25 qershorit ai do të jetë i qetë?**

Normale, pse jo.

**Vështirë të kontestohet rezultati i zgjedhjeve pas 25 qershorit tani?**

Nuk ka më arsye pse të kontestohet, garancitë janë dhënë. Edhe opozita është pjesë e procesit.

**Këto votat e Blushit apo të partive të tjera kush do i numërojë dhe mbrojë? Ata s'kanë numërues…**

Kjo është një çështje që duhet të ishte zgjidhur më kohë prandaj dhe është për të zbardhur keq që nuk u zbatuan rekomandimet e OSBE-ODIHR-it që duhet të ishin zbatuar prej kohësh. Megjithatë, ajo që besoj unë se do të jetë shumë e vështirë që dikujt t'i shkojë në mendje për të prekur votën e cilitdo.

**Po si do t'i monitoroni ju këto? Ka një lloj garancie?**

Ka kamera në qendrat e numërimit, ka edhe vëzhgues. Kjo çështja e numëruesve është më shumë çështje psikologjike, që bëhet më shumë për të dekurajuar partitë e tjera që thonë "të mos votoni për ata se nuk kanë numërues". Siç ia bënin LSI-së kur nuk kishte numërues LSI-ja në vitin 2009. Është më shumë psikologjike për të dekurajuar votuesit se sa reale dhe konkrete. Nuk është gjë e mirë, nuk është gjë normale, nuk duhet të ketë numërues partiakë ose përfaqësues të partive. Duhet një proces numërimi elektronik, diçka fare transparente.

**Rama dhe Basha kanë rënë dakord që menjëherë pas zgjedhjeve, sido që të jetë rezultati, të bëhet kodi i ri zgjedhor…**

Çdo gjë mund të bëhet, nuk ka rëndësi.

**A të vjen keq që e more atë post, për të cilit ju e thatë menjëherë pas zgjedhjes President se nuk ishit i lumtur?**

Si mund të jesh i lumtur në një moment kur opozita është në rrugë, është në protestë, kur opozita thotë se nuk do të hyjë në zgjedhje. I lumtur mund të jetë vetëm një njeri i papërgjegjshëm.

**Përtej kësaj, le ta themi se posti i Presidentit të Republikës nuk është se ka ndonjë kompetencë më në dorë?**

Nuk e di se çfarë por unë jam i nderuar që do të jem pas 24 korrikut Presidenti i Shqipërisë. Për kompetencat nuk jam shumë i shqetësuar. Të jesh President i vendit tënd, normalisht do të jesh i nderuar. Kjo është një detyrë e marrë në një moment të caktuar, në rrethana të caktuara dhe besoj që edhe pranimi nga ana ime e këtij posti kam përshtypjen që ndihmoi në zgjidhjen e kësaj krize.

**Po pse këta të tjerët që nuk të duan thonë se ju detyroi Rama?**

Nuk më detyron mua njeri. Ishte detyrim nga rrethanat, që ishin të tilla. mund të them që më detyroi opozita, sepse po të ishte opozita na Parlament mund ta merrte Presidentin. Por ajo situatë më detyroi të bëja këtë zgjidhje.

**Nëse do ta kërkonte opozita një gjë të tillë, sepse nuk e ka kërkuar..**

Nuk është se e ka kërkuar, por normalisht ishte një post që mund ta merrte për shkak të situatës.

**Doja një mendim nga ju për secilin nga presidentët që ka pasur Shqipëria në historinë e saj. Çfarë mendimi keni për Ahmet Zogun?**

Talenti i jashtëzakonshëm për kohën e tij.

**I dyti është Omer Nishani…**

Intelektual i nderuar, nuk mund të them diçka më shumë për aq sa kam lexuar.

**Çfarë mendoni për Haxhi Lleshin?**

Një figurë shumë interesante dhe simpatike.

**Çfarë mendoni për Ramiz Alinë?**

Një burrë që po ta gjykojmë nga niveli i intolerancës së sotme politike mund të themi që dha kontributin e tij që avioni të ulej në pistë pa përplasje katastrofike.

**Çfarë mendoni për Sali Berishën?**

Këtu jam subjektiv, pika ime e dobët dhe pika e fortë. Tani unë e di që ka edhe shumë njerëz që më duan mua, por nuk e duan atë. Por unë vlerësojë faktin që ai është një njeri tepër i qëndrueshëm dhe ka bindjet e veta.

Pavarësisht se çdo politikan ka ato hapësirat e veta ku bën edhe manovrat e tij politike, por Doktori është një partner shumë i qëndrueshëm dhe serioz, të paktën për aq kohë sa unë kam bashkëpunuar. Edhe kur nuk kuptohesh, është e qartë se nuk kuptohesh. Por ama kur kuptohesh je shumë i qetë.

**Po si u ndatë me Doktorin?**

Nuk ka qenë ditë e lumtur për mua, të jesh i sigurt.

**Ishte divorc i detyruar…**

Ne jemi ndarë shumë mirë dhe i ka mirëkuptuar pavarësisht se për arsye politike më pas mund të ketë pasur qëndrime apo deklarata. Unë kam konsideratë të veçantë.

**Çfarë do që të ndodhi nuk e ndryshon?**

Pse ta ndryshojë mendimin. Është një përvojë konkrete. E kaluara nuk ribëhet. Ai është politikan, ka qëndrimet e tij, ka partinë e tij, ka kryetarin e tij, është çështje tjetër. Por raporti im me të ka qenë një raport shumë i veçantë.

**Ai ka kryetarin e tij Lulzim Bashën siç keni ju kryetarin tuaj Petrit Vasilin…**

Nuk është e njëjta gjë po të paktën edhe kryetari im përsëri është doktor.

**Rexhep Mejdani?**

Mendoj se është një ikonë e integritetit dhe e provuar.

**Po për Alfred Moisiun çfarë konsiderate keni?**

Një njeri tepër i përgjegjshëm edhe patriot.

**Po për Bamir Topin?**

Tolerant, qytetar, bashkëpunues.

**Çfarë konsiderate keni për Presidentin Nishani?**

Mendoj që Presidenti Nishani është mjaft korrekt, institucional dhe bashkëpunues edhe kështu ka qenë gjithmonë në të gjitha pozicionet edhe kur ka qenë deputet, edhe Ministër i Drejtësisë edhe i Brendshëm. Shumë serioz, shumë bashkëpunues, shumë korrekt dhe shumë institucional.

**Po për ju si President çfarë konsiderate keni?**

Ende jo, ka kohë deri në24 korrik. Dhe nuk parapëlqej të shikoj veten time.

**Petriti është përgatitur që të marri akuza nga partitë e opozitës?**

Kjo është pyetje për Petritin dhe nuk dua të hyjë në replika me asnjë parti opozitare dhe i urojë suksese për zgjedhjet.

**Unë here pas here kam qejf të imagjinoj, kam qejf të shkoj në gjëra që nuk kanë ndodhur, por që mund të ndodhin. Vajza e vogël kur dëgjoi që u zgjodhët President, si reagoi?**

U habit. Ishte e papërgatitur dhe jo shumë e interesuar për këtë gjë.

**Gjithnjë kanë dashur t'ia hanë kokën, gjithnjë ka fituar Meta. Çudi e madhe!**

Nuk e kuptoj këtë shqetësimin për mua.

**Sikur Ilir Meta një moment të mos bëhej President, por të bëhej Kryeministër çfarë do të ndodhte. Intervista quhet "Ju kryeministër". Ilir Meta, ti kryeministër…**

Kam qenë.

**Jo, tani. Sikur të ishe tani, në vend të Ramës. A do ta kishit shtyrë takimin me Lulzim Bashën, që të mos bëhej në 17, por në një ditë tjetër, meqenëse ishte dita kundër homofobisë?**

Nuk ka asnjë arsye për paragjykim. Jam i sigurt që kjo krizë do të zgjidhej me kohë. Për çështjet e tjera nuk kam asnjë paragjykim.

**Ti kryeministër, a do të kishe refuzuar paketën "McAllister" me justifikimin se ajo dëmton rëndë shëndetin njësoj si paketa e cigares?**

Absolutisht jo.

**Ilir Meta, ti kryeministër, a do t'ia dorëzoje në tavolinë opozitës Niko Peleshin dhe Fatmir Xhafajn?**

Për një zgjedhje më të madhe, edhe gjëra më të rëndësishme mund të dorëzohen.

**Ilir Meta, ti kryeministër, a do ta kishe kundërshtuar me çdo kusht ikjen e kryetarit të LSI-së Petrit Vasili, nga posti i ministrit të Drejtësisë, për të mos u dukur mospërfillës me aleatin tënd politik LSI-në?**

Absolutisht që jo. Çdo sakrificë për mirëbesim ia vlen

**Ilir Meta, po të ishit kryeministër, a do ta kishe dorëzuar gjysmën e qeverisë dy muaj para zgjedhjeve?**

Për të shpëtuar zgjedhjet mund të kisha dorëzuar gjithë qeverinë. Zgjedhjet janë më të rëndësishme se sa qeveria, sepse janë stabiliteti i vendit, janë legjitimiteti i institucioneve, janë siguria e vendit, janë normaliteti i vendit.

**Ilir Meta po të ishit kryeministër a do të pranoje të tregoje fuqinë e partisë tënde, pra të futesh në zgjedhje pa koalicione?**

Kjo nuk është e rëndësishme.

**Ilir Meta, ti kryeministër, a do të kishe bërë të njëjtën gjë siç bëri z. Rama apo ndryshe?**

Një krizë e tillë nuk do të kishe zgjatur kurrë kaq shumë.

**Ilir Meta, ti kryeministër në vend të Piktorit, a do të kishe vënë vetes notë maksimale për lojë perfekte në qoftë se do të kishe ngecur postin e Presidentit Edi Ramës duke bërë që edhe PD-ja të mos kishte më besim te LSI-ja?**

Nuk do të më shkonte mendja për ushtrime kaq të vështira.

**Sa shanse ka që mes detajesh të fshihet eliminimi i LSI-së?**

Thash që tragjedia kur përsëritet është komedi, kështu që nuk ka shanse, mos ki merak.

**Po si synim mendon që është i vërtet?**

Absolutisht, nuk e besoj këtë gjë. Nuk kam pse ta besoj. Ti mendon që janë ulur se si të eliminojnë LSI-në dhe partitë e tjera? Ata janë ulur se si të zgjidhin çështje e zgjedhjeve. LSI është realitet dhe të gjithë bashkë të duan nuk kanë se çfarë t'i bëjnë LSI-së.

**Unë e di që atëherë nuk më gënjeve, por vërtetë nuk mendoje se doje të bëheshe president?**

Të jesh i sigurt se në qoftë se do të ishte bërë kjo zgjidhje përpara as nuk do të kishte ndodhur kjo gjë dhe e kam thënë këtë gjë, që mungesa e opozitës në Parlament ishte si një shtysë që unë ta pranoja këtë zgjidhje. Unë e di që kam thënë se nuk do të bëhem President. E kam thënë edhe në studio të tjera. Por kanë ndodhur disa rrethana që të gjithë i kuptojnë dhe i mirëkuptojnë.

**Po si ka mundësi që të gjithë ambientet politiko mediatike thonë se pakti i 1 prillit ishte 4 vjet Rama kryeministër, 5 vjet Meta President?**



Nuk ka pasur një pakt të tillë, por ka qenë diçka logjike që Presidenti normalisht duhet të ishte deri diku nga LSI-ja, sepse mund të ishte edhe jashtë koalicionit. Një person i propozuar nga LSI-ja, por i pranuar nga PS, për arsye sepse PS nuk i ka patur 71 mandate që normalisht të kishte edhe Presidentin. Kështu që kjo ka qenë logjika.

**Nuk ka pas një pakt të tillë?**

Nuk ka pasur një pakt të tillë. Kuptohet që Kryeministri do të ishte i partisë së parë dhe Presidenti i partisë së dytë.

**Në 24 korrik ju merrni detyrën. Çfarë do të bësh ndryshe nga Presidentët e tjerë, do të vazhdoj të jetosh këtu ku je me familjen apo do të shkosh të jetosh tek vila 24?**

Nuk kam patur kohë të mendoj për këtë gjë por do të vazhdojë jetën time si normalisht në raport me kontaktet, me njerëzit, me vendin kudo në të gjithë Shqipërinë. Natyrisht që nga 24 korriku do të kem një qëndrim dhe një sjellje krejt tjetër në përputhej me postin, me pozitën me qëndrimet e presidentit. Pra nuk mund të dalë më të flas për LSI-në siç fola sot tek ju.

**Po të jeni president do të vini në studio?**

Patjetër që do të vij.